



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEHNOLOGIJU
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY



**UDHËZUES PRAKTIK PËR ZBATIMIN E
KURRIKULËS**
(për klasën parafillore dhe arsimin fillor)



Mars, 2014



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEKNOLOGIJU
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY



UDHËZUES PRAKTIK PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS **(për klasën parafillore dhe arsimin fillor)**



Mars, 2014

Përgatitur nga:

Shqipe Gashi, zyrtare për kurrikula në MASHT

Diana Qarkaxhija, mësimdhënëse - bashkëpunëtore për kurrikula

Koordinuar nga:

Selim Mehmeti, Instituti Pedagogjik i Kosovës

Hajrije Devetaku - Gojani, Instituti Pedagogjik i Kosovës, &

Shqipe Gashi, zyrtare për kurrikula në MASHT

Lektor:

Bekim Morina, Instituti Pedagogjik i Kosovës

Botimin e mbështeti:

Zyra për trajnime në MASHT

Dizajni dhe faqosja nga:

Blendi, Prishtinë

Prishtinë, mars 2014

PËRMBAJTJA

Shkurtesat	6
1. HYRJJE	7
2. KORNIZA E KURRIKULËS SË KOSOVËS DHE KURRIKULA BËRTHAMË – ZBATIMI NË PRAKTIKË.....	11
2.1. Arritshmëria e qëllimeve të arsimit parauniversitar	11
2.2. Parimet e arsimit parauniversitar si referenca të organizimit të punës edukativo-arsimore	13
2.3. Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënit	17
2.3.1. Rezultatet e të nxënit për shkallë –kompetencë (RNSH) dhe arritshmëria e tyre	17
2.3.2. Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) dhe përmbajta mësimore.....	18
2.3.3. Rezultatet e të nxënit për klasë në nivel të fushës kurrikulare apo lëndës mësimore (RNL) brenda shkallës kurrikulare	20
3. ASPEKTET METODOLOGJIKE DHE PRAKTIKE TË PLANIFIKIMIT DHE TË ZBATIMIT TË KURRIKULËS SË RE	25
3.1. Plani mësimor	25
3.2. Plani i shkallës kurrikulare	27
3.3. Plani vjetor	29
3.4. Plani dymujor	34
3.5. Plani javor	39
3.6. Plani i orës mësimore	40
3.7. Çështjet ndërkurrikulare dhe korrelacioni në mes fushave kurrikulare /lëndëve mësimore.....	42
4. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES, MATERIALET MËSIMORE, VLERËSIMI DHE INSTRUMENTET E SAJ	45
4.1. Metodologjia e mësimdhësnies në funksion të KKK	45
4.2. Materialet mësimore (përzgjedhja dhe përgatitja e tyre).....	49
4.3. Aspektet metodologjike dhe praktike të vlerësimit	50
4.4. Bashkëpunimi i mësimdhënësve si domosdoshmëri për zbatim të kurrikulës së re	58
Shtojca	59
Shtojca 1 : Disa folje vepruese për hartimin e rezultateve të të nxënit dhe kritereve të vlerësimit.....	60
Shtojca 2 : Modele të planifikimeve të përgatitura nga mësimdhënësit	65
Shtojca 3 : Materiale mësimore të përdorura nga mësimdhënësit për mësimdhënie dhe vlerësim	80
Shtojca 4 : Pakoja e instrumenteve për planifikimin mësimor	90
Burimet dhe literatura	98

SHKURTESAT

KKK	Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës
KB	Kurrikula Bërthamë
FK	Fushë Kurrikulare
SHK	Shkallë Kurrikulare
RNSH	Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare – Kompetenca
RNF	Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare
RNL	Rezultatet e të nxënit për lëndë mësimore
PV	Plan Vjetor
PD	Plan Ditor
OM	Orë Mësimore
POM	Plani i Orës Mësimore
TM	Teknikë Mësimore
KSH	Kalendari Shkollor
KV	Kalendari Vjetor
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit

I. HYRJE

Udhëzuesi për zbatimin e Kurrikulës së re është doracak, i cili mbështet implementimin e filozofisë së Kornizës së Kurrikulës së Kosovës në praktikë. Ky udhëzues është vazhdimësi e dokumenteve kurrikulare, të cilat në mënyrë hierarkike e ndihmojnë dhe e bëjnë të zbatueshme njëra-tjetrën. MASHT-i pas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës (KKK), ka hartuar Kurrikulat Bërthamë (KB) për të vazhduar më pas me hartimin e Udhëzuesve praktikë për zbatimin e Kurrikulës, aktivitet të cilin e ka zhvilluar në bashkëpunim me Institutin Pedagogjik të Kosovës.

Udhëzuesi ofron informata për jetësimin e qëllimeve të arsimit parauniversitar, për respektimin parimeve të kurrikulës, kuptimin e zërthyeshmërisë së rezultateve të të nxënit për shkallë kurrikulare-kompetenca dhe për fusha të kurrikulës, të shkallës së parë dhe të dytë kurrikulare, në planifikime mësimore. Gjithashtu, udhëzuesi ofron aspekte metodologjike dhe praktike të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës së re, si dhe aspektet metodologjike dhe praktike të vlerësimit të arritjeve të nxënësve. Aspektet metodologjike të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës së re dhe të vlerësimit të arritshmërive të nxënësve mbështeten në praktikat e suksesshme të shkollës.

Rëndësia e udhëzuesit

Udhëzuesi mbështet zbatueshmërinë e KKK-së, respektivisht KB-ve, për klasën parafillore dhe arsimin fillor në shkollë. Shembujt e modeleve praktike të planifikimeve mësimore, të metodologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit, ndihmojnë ndërlidhjen e kurrikulës me punën mësimore në shkollë.

Qëllimi i udhëzuesit

Meqenëse mësimdhënësit janë agjentët kryesorë të zbatimit të filozofisë së KKK,-së udhëzuesi ka për qëllim ngritjen profesionale të mësimdhënësve për të kuptuar dhe zërthyer KKK, respektivisht KB e klasës parafillore dhe arsimin fillor në planifikime mësimore, në strategji e teknika të mësimdhënies, të nxënit dhe të vlerësimit të arritshmërive të nxënësve dhe në vetëvlerësim të procesit mësimor të organizuar nga vet mësimdhënësi duke e ndihmuar zhvillimin e kompetencave të caktuara të fëmijët e moshës që mbulon kurrikula bërthamë në fjalë.

Përdorimi i udhëzuesit

Udhëzuesi në fillim përdoret si material trajnues i trajnerëve për të zhvilluar më tej aftësitë profesionale të mësimdhënësve në zbatimin e KKK-së, respektivisht të KB të klasës parafillore dhe arsimit fillor. Kurse në të ardhmen llogaritet që ky udhëzues krahas me udhëzuesit për përmirësimin e praktikave në klasë (MASHT & SWAP, 2012), t'ju shërbej mësimdhënësve gjatë punës së pavarur në realizimin e kurrikulës së re - KB-së.

Rezultatet e pritura nga përdorimi i udhëzuesit

Duka pasur parasysh çështjet që trajtohen në udhëzues dhe strategjitë që praktikohen gjatë trajnimit, pritet që mësime të arrijnë këto rezultate:

- Të identifikojnë qasjet e arritshmërisë së qëllimeve të arsimit;
- Të identifikojnë qasjet e respektimit të parimeve në procesin arsimor, duke përfshirë planifikimet, metodologjitë dhe vlerësimin;
- Të identifikojnë elementet e domosdoshme të përbërjes së planifikimeve mësimore për zbatueshmëri të KB-ve;
- Të përgatisin modele të planifikimeve mësimore në të cilat përfshihen elementet e domosdoshme të KB-ve.
- Të përgatisin modele të strategjive të mësimeve dhe të të nxënësve, duke respektuar parimet e KKK-së, KB-ve;
- Të përgatisin dhe të shfrytëzojnë materialeve të ndryshme mësimore;
- Të zbatojnë strategji, teknika dhe instrumente të vlerësimit në pajtim me parimet e kurrikulës;
- Të zbatojnë strategji të bashkëpunimit kolegjial brenda dhe jashtë shkollës, si kurorëzim i suksesit të shkollës.

Organizimi i udhëzuesit

Udhëzuesi përbëhet prej katër kapitujve dhe shtojcës. Në secilin kapitull elaborohen çështje që u ndihmojnë mësimeve të kuptojnë ecurinë e zërimit të KKK-së, respektivisht të KB-ve të klasës parafillore dhe arsimit fillor në praktikën shkollore dhe t'i bëjnë ata agjentë të ndryshimeve.

Në kapitullin e parë - **Hyrje**, trajtohen rëndësia e udhëzuesit, qëllimi i udhëzuesit, përdorimi dhe përdoruesit e udhëzuesit, rezultatet e pritura nga përdoruesit e udhëzuesit dhe organizimi i udhëzuesit.

Në kapitullin e dytë - **Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe Kurrikulës Bërthamë – zbatimi në praktikë**, trajtohen çështje që ndihmojnë jetësimin e qëllimeve të arsimit parauniversitar, respektimin e parimeve të kurrikulës në procesin e arsimit në shkollë, kuptimin e zërithyeshmërisë të rezultateve të të nxënësve për kompetenca dhe për fusha kurrikulare të shkollës së parë dhe të dytë kurrikulare në planifikime mësimore.

Në Kapitullin e tretë - **Aspektet metodologjike dhe praktike të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës së re**, trajtohen çështje të planifikimeve mësimore, duke integruar elemente domosdoshme të KB-së, çështjet ndërkurrikulare dhe korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare dhe bashkëpunimi kolegjial në funksion të zbatimit të KB-ve.

Në kapitullin e katërt - **Metodologjia e mësimdhënies, materialet mësimore dhe instrumentet e saj**, trajtohen strategji të mësimdhënies dhe të të nxënit, duke përfshirë metoda, teknika të mësimdhënies dhe të të nxënit të suksesshëm, përgatitje dhe shfrytëzim të materialeve mësimore. Trajtohen metodat, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, respektivisht kompetencat, rezultatet e të nxënit dhe nivelet e njohjes në funksion të vlerësimit.

Shtojca përmban planifikime dhe materiale të mësimdhënies dhe të vlerësimit të punuar nga mësimdhënësit.

II. KORNIZA E KURRIKULËS SË KOSOVËS DHE KURRIKULA BËRTHAMË – ZBATIMI NË PRAKTIKË

Ky kapitull përqendrohet në:

- Arritshmërinë e qëllimeve të arsimit parauniversitar;
- Parimet e arsimit parauniversitar, si referenca të organizimit të punës edukativo-arsimore;
- Kuptimin dhe funksionin e rezultateve të të nxënit (të shkallëve kurrikulare - RNSH – kompetencave, të fushave kurrikulare - RNF dhe të lëndëve mësimore - RNL).

II.1 Arritshmëria e qëllimeve të arsimit parauniversitar

Qëllimet e arsimit parauniversitar

- *Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore;*
- *Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare;*
- *Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;*
- *Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;*
- *Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë; dhe*
- *Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.*

Qëllimet e arsimit parauniversitar të paraqitura në KKK janë pjesë përbërëse dokumenteve të kurrikulave bërthamë të të tri niveleve formale të arsimit parauniversitar. E gjithë përmbajtja e këtyre dokumenteve është në funksion të arritshmërisë së qëllimeve të arsimit parauniversitar. Kjo do të thotë që edhe rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare – kompetenca (RNSH) dhe rezultatet e të nxënit të fushave kurrikulare (RNF) të secilës shkallë kurrikulare janë në funksion të arritjes së qëllimeve të arsimit parauniversitar. Edhe e gjithë puna praktike edukativo-arsimore që zhvillohet në shkollë duhet të jetë në funksion të arritshmërisë së këtyre qëllimeve. Qasjet e arritjes së qëllimeve duhet t’u përshtaten moshës dhe mundësive të nxënësve të secilit nivel formal, përkatësisht secilës klasë. Shih **veçoritë e arsimit të klasës parafillore dhe arsimit fillor** në Kurrikulën Bërthamë (KB) për klasën parafillore dhe arsimin fillor, f. 16 dhe 17.

Si arrihen qëllimet?

Qëllimet e arsimit, të parapara në KB-në e klasës parafillore dhe arsimit fillor, arrihen kur ato bëhen pjesë e **planifikimeve** mësimore të secilës klasë, si të planifikimeve vjetore, mujore, javore, ditore dhe pjesë e procesit mësimor që zhvillohet në klasë dhe jashtë saj. Kjo do të thotë se në funksion të arritshmërisë së qëllimeve duhet të jenë këto aktivitete të udhëhequra nga mësimdhënësi:

- Përzgjedhja e rezultateve të të nxënit për shkallë - kompetencë (RNSH) që synohen të arrihen gjatë periudhave të caktuara, përmes përmbajtjeve (temave dhe njësive mësimore) dhe aktiviteteve brenda dhe jashtë orës mësimore;

- Përzgjedhja apo adaptimi i rezultateve të fushës apo lëndës të secilës klasë nga planet dhe programet ekzistuese, që korrespondojnë me rezultatet e të nxënësve të fushave kurrikulare;
- Përzgjedhja e përmbajtjes mësimore (temave apo njësive mësimore);
- Përzgjedhja e metodologjive të mësimdhënies dhe të të nxënësve;
- Përzgjedhja e materialeve dhe burimeve mësimore;
- Përzgjedhja e metodologjive, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit;
- Përzgjedhja e formave të komunikimit;
- Krijimi i klimës në klasë dhe shkollë, në favor arritjes së qëllimeve.

Qëllimet nuk mund të kuptohen si fiksime të veçanta, që arrihen secila ndaras nga njëra-tjetra, por, në shumicën e rasteve, funksionojnë si tërësi.

Shembull i arritjes së qëllimeve të arsimit parauniversitar përmes fushës kurrikulare **Shoqëria dhe mjedisi**.

Shkalla II, kompetencat 5.8, 6.2, 6.4, 6.7.

Shkalla II, fusha kurrikulare Shoqëria dhe mjedisi, rezultati 1.1

Rezultati i fushës kurrikulare - lëndës mësimore Shoqëria dhe mjedisi (në këtë fushë – lëndë mësimore gjenden elementet e historisë, gjeografisë dhe edukatës qytetare), klasa e 5-të, p.sh. rezultati, nr? “Nxënësi identifikon elementet e kulturës në Kosovë”.

Përmbajtja mësimore (Tema mësimore): Veshjet kombëtare.

Përmbajtja mësimore (Njësia mësimore): Veshjet kombëtare të burrave në rajonin e Rugovës.

Qëllimet e synuara mund të jenë:

- *Kultivimi i identitetit kombëtar.*

Por nëse nxënësit angazhohen në gjetjen e pjesëve të veshjes kombëtare në mënyrë individuale a grupore, atëherë:

- *Promovohet bashkëpunimi si vlerë e përgjithshme kulturore dhe qytetare;*
- *Rritet përgjegjësia ndaj vetes dhe të tjerëve (për detyrën individuale brenda detyrës së përbashkët);*
- *Rriten angazhimi dhe iniciativa si pjesë e ndërmarrësisë;*
- *Krijohet mundësia për punë të pavarur.*

(Kujto qëllimet e arsimit parauniversitar).

Në këtë rast, vijnë në shprehje metodologjia e punës, materialet dhe burimet e informacionit, klima pozitive.

(Kujto aktivitetet që mësimdhënësi i bën për arritjen e qëllimeve parauniversitare).

Aktivitet: Pasi që keni lexuar dhe analizuar informacionet/udhëzimet e dhëna për arritshmerisë e qëllimeve të arsimit parauniversitar, diskutoni me kolegë:

1. Si mund të integrohen dhe respektohet qëllimet e arsimit parauniversitar konkretisht në kuadër të një fushe të kurrikulës - në klasën parafillore dhe arsimin fillor, p.sh. klasën e parë.

2. Merrni shembuj në njërin nga fushat e kurrikulës dhe në nivele të ndryshme të planifikimit

dhe metodologjisë së mësimdhënies dhe nxënies

Fusha e kurrikulës/Lënda: _____

Klasa: _____

Tema: _____ Njësia mësimore _____

Rezultatet mësimore:

Qëllimet e arsimit që synohen të arrihen dhe përshkrimi i anës praktike për arritjen e qëllimeve gjatë punës me nxënës:

II.2 Parimet e arsimit parauniversitar, si referenca të organizimit të punës edukativo-arsimore

<i>Parimet</i>
<ul style="list-style-type: none">• <i>Gjithëpërfshirja;</i>• <i>Zhvillimi i kompetencave;</i>• <i>Mësimdhënia dhe të nxënësve të integruar dhe koherent;</i>• <i>Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle;</i>• <i>Përgjegjësia dhe llogaridhënia.</i>

Parimet janë një lloj i rregullave, të cilat e mbështesin punën edukativo-arsimore në arritjen e qëllimeve të arsimit parauniversitar. Ato e mbështesin punën edukativo-arsimore të mësimdhënësve të klasës parafillore dhe të arsimit fillor. Ato janë udhërrëfyes të punës së suksesshme të mësimdhënësve që reflektohen në përgatitjen e nxënësve të këtij niveli për sfidat e tanishme në të nxënë, në zgjidhje të problemeve në raport me potencialet e tyre dhe në përgatitjen për të nxënë të mëtutjeshëm. Mësimdhënësit punën e tyre edukativo-arsimore duhet ta mbështesin në parimet e përcaktuara në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës (KKK), respektivisht në KB të klasës parafillore dhe arsimit fillor. Kjo do të thotë që edhe kurrikula bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor është ndërtuar mbi bazën e parimeve që janë përcaktuar në KKK (Shih KKK, f. 31) dhe gjithashtu edhe zbatimi praktik i saj duhet të bëhet mbi bazën e tyre.

Si mund të jemi në linjë të parimeve?

Në linjë të **parimit të gjithëpërfshirjes** jemi atëherë kur:

- Kemi **planifikuar** duke diagnostikuar përvojat, dijet, kulturat, stilet e të nxënimit të nxënësit-es dhe e kemi përmirësuar mësimdhënien;
- Kemi planifikuar duke synuar;
- Kemi përdorur **llojlojshmëri të metodave, teknikave dhe materiale** të ndryshme të mësimdhënies dhe të të nxënimit, detyra të diferencuara për realizim të aktivitetit.

Dhe nxënësi-sja:

- Ndihet i pranuar në klasë nga nxënësit-set, edhe nga mësimdhënësi-sja njëjtë si të gjithë nxënësit, pa dallim, qoftë të potencialit, gjinisë, përkatësisë fetare, përkatësisë sociale, ekonomike, shëndetësore, etnike dhe kulturore;
- Ndihet i-e respektuar sa u përket, dinjitetit, përvojës, dijeve, stileve të të nxënimit dhe mënyrës së të shprehurit dhe mendimit.

Sepse kemi krijuar klimë që secili-la ndihet rehat, i-e çmuar, kontribuues-e dhe i-e suksesshëm-e.

Në linjë të **parimit të zhvillimit të kompetencave** jemi atëherë kur:

- Kemi **planifikuar** duke pasur parasysh rezultatet e të nxënimit të shkallës – kompetencës (RNSH), rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare (RNF) të shkallës së parë apo të dytë kurrikulare dhe rezultatet e fushës apo lëndës për klasë (parafillore, e parë,... e pestë) të marrë dhe të adaptuar nga planet e programet ekzistuese, e nëse jo i kemi hartuar vetë;
- Kemi aplikuar **metodologji dhe mjete didaktike**, të cilat kanë nxit dëshirë, kreativitet dhe pavarësi;
- Kemi përdorur **teknika dhe instrumente të vlerësimit**, të cilat e kanë ndihmuar vetëvlerësimin, identifikimin e saktë të shkallës së arritshmërisë dhe pastaj marrjen e masave për përmirësim.

Dhe nxënësi-sja:

- Identifikon, krahason, analizon dhe vlerëson, ngjarje dukuri dhe zgjidh probleme në pajtim me rezultatet e të nxënimit të fushës apo lëndës për klasën parafillore, apo klasat e arsimit fillor;
- Demonstron shkathtësi të komunikimit (dëgjon dhe është konstruktiv në dhënien e mendimeve, qoftë verbalisht, me shkrim apo me vizatim), të menaxhimit të detyrës, aktivitet, kohës dhe mjeteve, shfrytëzimit të burimeve...;
- Demonstron vlera, si tolerancë, mirësjellje, solidaritet-përkrahje, respekt dhe përgjegjësi ndaj vetes, të tjerëve dhe mjedisit;
- Demonstron qëndrim për diçka, si për sjellje, ngjarje a dukuri;
- Demonstron iniciativa, pjesëmarrje për ndryshim;
- Menaxhon emocionet e veta, nuk është arrogant-e, konfliktuoz-e, i-e tensionuar...

Dhe, kështu zhvillojmë nxënës-e kompetent-e

Në linjë të parimit të mësimdhënies së integruar dhe të të nxënit koherent jemi atëherë kur:

- Kemi **planifikuar** lidhje ndërlëndore brenda fushës së njëjtë, përmes përzgjedhjes së temave të përbashkëta;
- Kemi **planifikuar** lidhje në mes të fushave kurrikulare, ashtu që të ndihmojmë zhvillimin e gjuhës të shkencat, artet, jeta dhe puna, por edhe të matematika; apo ndihmojmë zhvillimin e temave të shkencave, shoqërisë dhe mjedisit përmes matematikës, gjuhës dhe arteve (p.sh. vjeshta, temë- njësi mësimore e shkencave ndihmohet të realizohet përmes esesë të gjuha, përmes artit e edhe muzikës; p.sh. foljet, mbiemri, emri - njësi mësimore të gjuhës përmes teknikës së pesëvargëshit zhvillohen të shkencat natyrore, të shoqëria dhe mjedisi etj.)
- Kemi **planifikuar** module dhe projekte, ku gjenden elemente të fushave kurrikulare, p.sh. projekti Mbjellja e luleve në një kënd të oborrit të shkollës - atëherë kanë ardhur në shprehje shkencat natyrore, duke e studiuar kohën e përshtatshme për mbjellje..., matematika duke matur thellësinë e gropës të përshtatshme për lulet, shoqëria dhe mjedisi duke ditur rëndësinë ruajtjes dhe krijimit të një mjedisi të këndshëm, shëndeti dhe mirëqenia, artet etj.

Dhe, nxënësi-sja:

- Analizon një detyrë, situatë, ngjarje a dukuri në kënde të ndryshme (p.sh të një lloj ushqimi, identifikon përbërjen, mënyrën e përdorimit dhe vendin e prodhimit – këtu ka elemente të shkencave të natyrës, jetës dhe punës, por edhe të shoqërisë dhe mjedisit; (p.sh. trupat gjeometrikë- forma mendojmë në matematikë, shkenca të natyrës, arte etj).
- Identifikon ndërlidhjen dhe ndërvarësinë e detyrave, ngjarjeve dhe dukurive (p.sh. bimët na ndihmojnë të kemi jetë të shëndoshë, sepse kem ajër të pastër dhe..., dhe ne i ruajmë, kujdesemi dhe i kultivojmë ato).

Dhe, kështu zhvillojmë të nxënë gjithëpërfshirës dhe koherent

Në linjë të parimit të autonomisë dhe fleksibilitetit jemi atëherë kur:

- Kemi përgatitur **plan mësimor** (shpërndarje të orëve mësimore për fusha kurrikulare dhe lëndë mësimore) dhe **planifikime mësimore** (vjetore, mujore, ditore) në pajtim me rezultatet e të nxënit për shkallë-kompetencë (RNSH), rezultateve të të nxënit për fushë kurrikulare (RNF) për shkallë dhe rezultateve të të nxënit për fushë kurrikulare apo lëndë mësimore për klasë dhe në pajtim me përvojat, ritmet e stileve të të nxënit të nxënësve të cilët-at i udhëheqim;
- Kemi hartuar **kurrikulë zgjedhore** në pajtim me talentin, afinitetet dhe interesat e nxënësve;

Dhe, nxënësi-sja:

- Nxë në bazë të ritmeve individuale të të nxënit;
- Nxë sipas stilit individual;
- Zhvillon talentin dhe nxë mbi bazën e afiniteteve dhe interesave.

Dhe, kështu zhvillojmë nxënës-e të suksesshëm-e

Në linjë të **parimit të përgjegjësisë dhe llogaridhënës** jemi atëherë kur:

- Jemi **transparentë** për saktësinë dhe nivelin e arritjes së kompetencave dhe rezultateve për secilën detyrë, aktivitet me secilin nxënës-e dhe i kemi diskutuar rrugët e arritjes;
- Jemi **transparentë** dhe në komunikim të vazhdueshëm me prindër për të arriturat e rezultateve të të nxënësve për shkallë-kompetenca (RNSH) dhe rezultateve të të nxënësve të fushës kurrikulare (RNF), lëndës a temës mësimore;
- Jemi **transparentë** me Këshillin e klasës, Këshillin e mësimdhënësve të shkollës dhe këshillat e tjerë që funksionojnë në shkollë për nivelin e arritjes së rezultateve të kompetencave, fushave, lëndës a temës për paralelet të cilat i udhëheqim.

Dhe, nxënësi-sja:

- Është në dijeni për nivelin e arritjes së vetë në pajtim me kërkesat e shtruara nga mësimdhënësi;
- Prindërit janë në dijeni për nivelin e arritjes së fëmijëve të tyre në pajtim me rezultatet e të nxënësve të shkollës – kompetencës (RNSH), rezultateve të të nxënësve të fushës kurrikulare (RNF) për shkallë, rezultateve të të nxënësve të lëndës (RNL) a temës mësimore për klasë;
- Këshilli i klasës, Këshilli mësimdhënësve të shkollës dhe këshillat e tjerë që funksionojnë në shkollë janë në dijeni për nivelin e arritjes së nxënësve të paraleles.

Dhe, kështu përmirësojmë mësimdhënien dhe rrisim të nxënësve e nxënësve

Aktivitet : *Pasi që keni lexuar dhe analizuar informacionet/udhëzimet e dhëna për Parimet e arsimit parauniversitar referenca të organizimit të punës edukativo arsimore,, diskutoni me kolegë: si mund të integrohen dhe respektohet parimet e arsimit parauniversitar konkretisht në kuadër të një fushe të kurrikulës - në klasën parafilllore dhe arsimin fillor, p.sh. klasën e parë. Merrni shembuj në lëndën tuaj dhe në nivele të ndryshme të planifikimit **dhe metodologjisë së mësimdhënies dhe nxënies***

Fusha e kurrikulës/Lënda: _____

Klasa: _____

Tema: _____ **Njësia mësimore** _____

Rezultatet mësimore: _____

Parimet që shpërbëjnë si pikënisje dhe përshkrimi i anës praktike për parimet që respektohen gjatë punës me nxënës:

II.3 Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënit

Rezultatet e të nxënit

- *Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare –kompetencë (RNSH) dhe arritshmëria e tyre;*
- *Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) dhe përmbajta mësimore;*
- *Rezultatet e të nxënit për klasë në nivel të fushës kurrikulare apo lëndë mësimore, brenda shkallës kurrikulare.*

II.3.1 Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare –kompetencë (RNSH) dhe arritshmëria e tyre

Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare - kompetenca (RNSH) për shkallën e parë dhe të dytë kurrikulare janë kërkesa që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit në fund të secilës nga këto shkallë. Ato janë njohuri, shkathtësi, qëndrime, vlera dhe rutina, të cilat duhet zhvilluar te secili nxënës-se përgjatë klasave sa ka shkalla e parë dhe shkalla e dytë kurrikulat. (Shih KB, rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare - RNSH, f. 19-29).

Si zhvillohen (arrihen) kompetencat?

Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht arritshmëria e rezultateve të tyre, bëhet përmes fushave kurrikulare. Të gjitha fushat kurrikulare apo lëndët mësimore që mbahen në klasën parafillore, në klasën e parë dhe në klasën e dytë, duhet të kontribuojnë bashkërisht në arritjen e rezultateve të kompetencave të shkallës së parë. E njëjta gjë duhet të ndodhë edhe me fushat kurrikulare dhe klasat që ka shkalla e dytë kurrikulare.

Nuk do të thotë që domosdo secila fushë kurrikulare si e vetme të arrijë të gjitha rezultatet e të gjitha kompetencave, por secila fushë kurrikulare duhet të fiksojë rezultatet e të nxënit për shkallë - kompetencë që do t'i synojë t'i arrijë për secilën klasë. Mund të ndodhë që disa rezultate të njëjta të kompetencave të jenë pika synuese për disa fusha kurrikulare, por mund të ndodhë që disa të përzgjedhjen nga një fushë e vetme.

P.sh. rezultati IV.2 , shkalla e parë, f 21, nxënësi-sja *“Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj)”* është rezultat që arrihet përmes të gjitha fushave kurrikulare, ose rezultati I. 9, shkalla e parë, f 20 nxënësi-sja *“Emërton në gjuhën e huaj objekte veprime ose dukuri dhe i përkthen në gjuhën amtare fjalët që i dëgjon nga gjuha e huaj, të dhëna në detyrë”*, është rezultat që arrihet përmes fushës gjuhët dhe komunikimi apo më specifike lëndës mësimore gjuhës angleze, por **KUJDES! Të gjitha rezultatet duhet të arrihen deri në fund të shkallës kurrikulare.**

Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare-kompetenca (RNSH) mund të jenë të synuara në çdo klasë sa ka shkalla, por arritshmëria e tyre duhet të bëhet në pajtim me moshën dhe mundësitë e nxënësve.

P.sh. rezultati I.1, shkalla e parë, f 20, nxënësi-sja *“Lexon një tekst të palexuar më parë, së paku prej gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës”* ndoshta nuk mund të arrihen nga të gjithë nxënësit e klasës së parë, por mjafton që ata të jenë në gjendje të lexojnë fjali të palexuara me parë. **Arritshmëria e plotë e këtij rezultati duhet të arrihet deri në fund të klasës së dytë.**

Në mënyrë që rezultatet e të nxënit për kompetencë të jenë të arritshme, ato duhet të jenë të pranishme pothuajse në të gjitha planifikimet mësimore të secilës fushë kurrikulare.

II.3.2 Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) dhe përmbajta mësimore

Rezultatet e të nxënit të fushave kurrikulare (RNF) janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme të fushës përkatëse dhe janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore.

Konceptet janë shtylla përmbajtjesore, rreth së cilave organizohet e gjithë përmbajtja mësimore e fushës kurrikulare brenda shkallës kurrikulare. Ato janë të pranishme në klasat e shkallës kurrikulare. Fuqia e prezencës së tyre në periudha të ndryshme kohore brenda një viti shkollor të një klase të caktuar, por edhe të klasave të ndryshme të shkallës së njëjtë mund të jetë e larmishme.

Si e përzgjedhim përmbajtjen nga RNF?

Me rastin e përzgjedhjes së rezultateve të të nxënit të fushës së caktuar kurrikulare, të cilat synojmë t'i arrijmë me nxënësit në klasë të caktuara, së pari duhet identifikuar konceptet e fushës kurrikulare, nga të cilat dalin rezultatet e caktuara. Shih **shembullin** e ndërlidhjes së rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare (RNF) me konceptet e fushës kurrikulare.

Fusha kurrikulare - Shoqëria dhe mjedisi, shkalla e parë kurrikulare

Koncepti i fushës	Qëllimi i konceptit	RNF
Proceset shoqërore	<i>Koncepti proceset shoqërore nënkupton zhvillimet dhe ndryshimet që ndodhin në jetën shoqërore në rrethin ku jeton: në familje, në shkollë në komunitet dhe në vend, lëvizjen natyrore dhe migrimin e popullsisë, duke nënkuptuar mënyrën e jetesës dikur dhe sot. Kjo gjithashtu nënkupton pjesëmarrje, në mënyrë aktive, në proceset dhe organizimet familjare, shkollore dhe më gjerë, në rrethin ku jeton. Në kuadër të këtij koncepti bëjnë pjesë edhe njohuritë, qëndrimet dhe vlerësimet për traditat, festat, vlerat e trashëgimisë kulturore dhe historike, procese shoqërore që lidhin ndryshimet në jetën e përditshme të tyre dhe në kohë të ndryshme.</i>	I Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes apo të përfshirjes në to I.1 Tregon për vetveten, familjen e ngushtë dhe të gjerë (dallon moshën dhe prejardhjen), organizimin e hapësirës së banimit dhe veprimit, lëvizjet natyrore të popullsisë, migrimet, vendbanimet dhe veprimtaritë ekonomike.

Ndodh që disa koncepte të fushës kurrikulare të jenë të pranishme në një rezultat të fushës kurrikulare, por sidoqoftë njëra nga to ndihet më fuqishëm.

Konceptet e fushës kurrikulare së bashku me rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare na ndihmojnë në përzgjedhjen e përmbajtjes mësimore (temave mësimore) për fushën kurrikulare për secilën klasë sa ka shkalla kurrikulare.

Temat mësimore janë tërësi mësimore, të cilat mbulojnë apo përfaqësojnë të gjitha lëndët mësimore brenda një fushe kurrikulare, gjatë periudhave të caktuara kohore të një viti shkollor.

Shih **shembullin** e fushës kurrikulare Shoqëria dhe mjedisi, shkalla e parë, (klasa e parë).

Hapi 1	hapi 2	hapi 3
Konceptet	RNF	Tema mësimore
Proceset shoqërore	<p>I Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes apo të përfshirjes në to</p> <p>I.1 Tregon për vetveten, familjen e ngushtë dhe të gjerë (dallon moshën dhe prejardhjen), organizimin e hapësirës së banimit dhe veprimit, lëvizjet natyrore të popullsisë, migrimet, vendbanimet dhe veprimtaritë ekonomik.</p>	<p>Unë dhe shoqëria</p> <p>(familja, shkolla, komuniteti veprimtaritë ekonomike, puna dhe profesionet, festat dhe traditat, vlerat dhe qëndrimet, sjelljet).</p>

Temat mësimore janë të vlefshme për gjitha lëndët mësimore sa ka fusha kurrikulare. Por, mund të ketë raste që nga disa rezultate të fushës kurrikulare të përcaktojmë përmbajtjen - temën mësimore, vetëm për një lëndë mësimore.

P.sh. fusha gjuhët dhe komunikimi, shkalla 2, rezultati I. 1 *“Përdor forma më komplekse të gjuhës për të komunikuar me të tjerët për përmbajtjen dhe qëllimin e teksteve”* është rezultat që anon më shumë ka lënda e Gjuhës amtare, sepse nuk mund të jetë i arritshëm për të gjithë nxënësit përmes gjuhës së huaj, sepse gjuha e huaj nuk e ka statusin e barabartë me gjuhën amtare sa u përket kërkesave të arritshmërisë, por edhe fondit të orëve.

Duke pasur parasysh parimin e mësimdhënies së integruar dhe koherente, mësimdhënia përmes temave të përbashkëta për të gjitha lëndët mësimore do të jetë në funksion të respektimit të tij. Kjo do të thotë se secila lëndë mësimore duhet të mbërrijë rezultatin e fushës përmes temës së përbashkët të fushës, por secila nga këndi i vet, me njësi mësimore të lëndës së vet. Në shkallën e parë dhe në të dytën kjo qasje vlen për fushën Gjuhët dhe komunikimi, sepse përbëhet prej lëndëve: Gjuhë amtare, Gjuhë e huaj (shkalla 1) dhe Gjuhës shqipe për komunitetin joshqiptar (shkalla 2) dhe për fushën kurrikulare Artet, sepse përbëhet prej lëndëve: Art figurativ dhe Art muzikor. Ndërsa fushat, shkencat natyrore, shoqëria dhe mjedisi, matematika, shëndeti dhe mirëqenia (shih fushën shëndeti dhe mirëqenia f. 70-72) dhe jeta dhe puna në shkallën e parë dhe të dytë janë edhe lëndë mësimore, edhe fusha kurrikulare.

II.3.3 Rezultatet e të nxënit për klasë në nivel të fushës kurrikulare, apo lëndës mësimore (RNL) brenda shkallës kurrikulare

Meqenëse rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare në Kurrikulën Bërthamë të klasës parafillore dhe arsimit fillor paraqiten për shkallë e jo për klasë mësimore, atëherë konsiderohet si nevojë hartimi i rezultateve të të nxënit për klasë mësimore, respektivisht lëndë mësimore, sepse sigurohet kohezioni dhe mosngarkesa e njërës klasë brenda një shkalle kurrikulare.

Si hartohen rezultatet për klasë dhe lëndë mësimore?

Hartimi i rezultateve të të nxënit për klasat e shkallës së parë dhe të dytë kurrikulare mund të bëhet nga vetë mësimmësuesit, por edhe të merren nga planet dhe programet ekzistuese. Nëse shfrytëzohen planet dhe programet ekzistuese atëherë shkrimi i tyre bëhet duke i krahasuar rezultatet e pritshme të lëndëve mësimore të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e të nxënit, fushës kurrikulare të kurrikulës bërthamë. Në këtë rast bëhet përzgjedhja e rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese që janë në funksion të arritjes të secilit rezultat të të nxënit të fushës kurrikulare të kurrikulës bërthamë. Nëse rezultatet e pritshme të përzgjedhura nga planet dhe programet nuk përmbushin në tërësi rezultatin e caktuar të fushës kurrikulare, atëherë mund të shkruhen edhe rezultate të reja. Rezultatet e fushës kurrikulare apo lëndës mësimore për klasë mësimore na ndihmojnë në përcaktimin e njësive mësimore, të cilat janë në funksion të temës së përbashkët të fushës kurrikulare. Shih formatin e mundshëm të tabelës të hartimit të rezultateve për fushë apo lëndë mësimore në nivel klase. Ky format duhet të zhvillohet sipas hapave të dhënë në tabelë.

Për çështje praktike, rezultateve të fushës kurrikulës (RNF) marrë nga Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor, por edhe rezultateve të planeve dhe programeve ekzistuese, është mirë që t'u vendosen nga një numër kur vendosen në këtë tabelë, në mënyrë që të dihet saktë se cilat rezultate korrespondojnë me njëra-tjetrën. Nëse njërit rezultat të fushës kurrikulare në nivel shkalle i keni vendosur numrin 1, atëherë rezultateve të planeve dhe programeve që korrespondojnë me këtë rezultat t'u vendosen numrat p.sh 1.

Rezultatet e të nxënit janë deklarata, të cilat duhet të hartohen në mënyrë të strukturuar. Struktura e rezultatit të të nxënit për lëndë përmban katër pjesë kryesore: Veprimi (V), Qëllimi(Q), Kushti (Ku) dhe Kriteri (K)

Shembull jo i drejtë i shkrimit të rezultatit

Nxënësi:

- Të dijë (veprim) të modelojë një objekt (qëllim) me plastelinë (kusht).

Shembull i drejtë i shkrimit të rezultatit

Nxënësi:

-Modelon (veprim) shkronjën A (qëllim) me plastelinë me ngjyrë të kuqe(kusht).

-Përdor (veprim) saktësisht (Kriteri/Kërkesa) Teoremën e Pitagorës (qëllim) për të gjetur gjatësinë e diagonales së një katrori, duke e bazuar në vlerat e perimetrit (kusht).

Pasi të keni shkruar rezultatet e të nxënit për lëndë mësimore (RNL), atëherë mund të bëni ndërlidhjen e tyre me rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare - kompetenca (RNSH). Shih shembullin më poshtë.

Shembull i ndërlidhjes se RNSH me RNF dhe RNL në klasën e parë (shkalla e parë)

Hapi 1	hapi 2	Hapi 3
RNSH (kompetenca)	RNF- gjuhë dhe komunikim	RNL
I. Komunikues efektiv 1.1 Lexon me zë një tekst të palexuar me parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet. ↓	I.2.1 Përdor strategji për të lexuar me kënaqësi tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë, si dhe elementet e përdorimit të gjuhës.	1. Lexon fjalë dhe fjali qartë dhe saktë që kanë në përbërje shkronjat e mësuara (P.sh. shkronjën Rr) . 2. Shpjegon domethënien e fjalëve dhe fjalive të lexuara nga teksti i dhënë si detyrë (p.sh. që kanë në përbërje shkronjën rr).

***MENDO!** Ky rezultat në fjalë i kompetencës është i synuar, por jo domosdo i arritur në klasën e parë. Në këtë klasë mund të jenë tekste edhe më të shkurtra prej disa fjalëve e fjalive.*

Aktivitetet: Përgatitni një shembull të ndërlidhjes se RNSH me RNF dhe RNL në klasën e parë (shkalla e parë)

Hapi 1	hapi 2	Hapi 3
RNSH (kompetenca)	RNF- Shoqëria dhe mjedisi	RNL
Kompetenca qytetare – qytetar i përgjegjshëm		

Lista e rezultateve të të nxënit për lëndë, duhet të bëhet nga një proces krahasimi i rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e fushave kurrikulare në KB, p.sh. fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi. Nga procesi krahasues plotësohet tabela në vijim, e cila rezulton me rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore. Udhëzimet për hapat e krahasimit të rezultateve janë dhënë në shtojësen nr.1 të këtij udhëzuesi.


Krahasimi i rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e fushave kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi të kurrikulës bërthamë (KB)										
Shkalla 1										
Rezultatet e të nxënit të fushës Gjuhë dhe komunikimi (RNF) marrë nga KB.	Rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese të lëndëve mësimore që korrespondojnë me RNF të KB.			Rezultatet pritshme që duhet të shtohen në planet dhe programet e lëndëve mësimore.			Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL).			
	Lënda	Klasat			Klasat			Klasat		
		Parafillore	E parë	E dytë	Parafillore	E parë	E dytë	Parafillore	E parë	E dytë
Gjuhë amtare -shqipe										
Gjuhë angleze										

Aktivitet:

Pasi që keni lexuar dhe analizuar informacionet e dhëna për kuptimin dhe funksionin e rezultateve të të nxënit, udhëzimet se si vijmë deri te rezultatet e të nxënit për klasë/lëndë mësimore, hartoni me kolegë rezultatet e të nxënit për një fushë të kurrikulës, për klasën parafillore, klasën e parë dhe klasën e dytë:

1. Vendosni rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese të lëndëve mësimore që korrespondojnë me RNF të KB
2. Vendosni rezultate të pritshme që duhet të shtohen në planet dhe programet e lëndëve mësimore me qëllim të arritjes së rezultateve të fushës/ave së kurrikulës
3. Vendosni rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e fushës së kurrikulës/lëndëve mësimore (RNL)

Nga ajo që u përshkrua më lartë lidhur me hierarkinë e ndërlidhjes së RNSH dhe RNF me nivelet tjera të planifikimit që zhvillohen në nivel shkolle, prezantohet figura në vijim, e cila orienton mësime dhënësit dhe akterët tjerë në shkollë se si ti qasen planifikimit mësimor dhe gjithashtu tregon se me arritjen e planifikimit mësimor në nivelin e caktuar si ndikojmë në arritjen e RNSH dhe RNF të vendosura në Kurrikulën Bërthamë.



III. ASPEKTE METODOLOGJIKE DHE PRAKTIKE TË PLANIFIKIMIT DHE TË ZBATIMIT TË KURRIKULËS SË RE

Ky kapitull përqendrohet në procesin e planifikimit mësimor, si:

- *Planin mësimor;*
- *Planin e shkallës kurrikulare;*
- *Planin vjetor;*
- *Planin dymujor;*
- *Planin javor;*
- *Planin e orës mësimore;*
- *Çështjet ndërkurrikulare dhe korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare.*

III.1 Plani mësimor

- *Fusha kurrikulare /lëndë mësimore;*
- *Orë mësimore.*

Si përgatitet plani mësimor në nivel shkolle?

Para se të bëhet plani më i detajuar i procesit mësimor për një vit shkollor (plani vjetor dhe dymujor), së pari duhet përcaktuar saktë planin mësimor për klasën, përkatësisht vitin shkollor (mësimor). Në Kurrikulën Bërthamë të klasës parafilllore dhe arsimit fillor ekziston një masë lirie në organizimin e planit mësimor, shih KB, f 90 dhe 91. Kjo do të thotë se mund të lëvizë numri i orëve brenda fushës së njëjtë të shkallës kurrikulare nga klasa në klasë apo nga gjysmëvjetori në gjysmëvjetor. Mund të bëhet ndarja e orëve mësimore në mes të lëndëve të ndryshme mësimore brenda fushës së njëjtë kurrikulare gjatë një viti shkollor, apo për gjitha klasat sa ka shkalla kurrikulare. Por, kujdes!, nuk duhet tejkaluar totali i fondit javor që është caktuar me Kurrikulën Bërthamë për secilën klasë.

***P.sh.**, në fushën kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi, në planin mësimor në Kurrikulën Bërthamë (KB) për shkallë e parë për tri vite shkollore si total i orëve mësimore jepen 21 orë për një gjeneratë. Kjo fushë kurrikulare në shkallën e parë përbëhet prej lëndës Gjuhë amtare dhe lëndës Gjuhë e huaj (angleze). Gjuha amtare është lëndë që domosdo duhet filluar nga klasa parafilllore dhe duhet të jetë e pranishme në të gjitha klasat sa ka shkalla e parë. Gjuhës së huaj prej 21 orëve i takojnë 3 orë mësimi për tri vite shkollore (mësimi). Atëherë mësimdhënësi-sja vendos, në bashkëpunim me drejtorin-en e shkollës dhe prindërit se kur do të fillohet me mësimin e gjuhës angleze, përkatësisht në cilën klasë dhe me sa orë mësimi në javë. Por, në momentin kur fillon gjuha angleze ajo nuk duhet ndërprerë, sepse humbet kontinuiteti.*

Për të arritur deri te një marrëveshje, se me cilat lëndë do të fillohet dhe si do të bëhet ndarja e orëve, duhet pasur parasysh edhe disa kritere që janë përcaktuar në Kurrikulën Bërthamë të klasës parafillore dhe arsimit fillor, si:

- Duhet lexuar me kujdes rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi, se cilës gjuhë i jepet përparësi në shkallën e parë.
- Duhet lexuar me kujdes rezultatet e të nxënit për shkallë-kompetenca, e sidomos kompetencës Komunikues efektiv, se cili duhet të jetë niveli i arritjes së gjuhës amtare. Se cili mund të jetë niveli i arritjes së gjuhës së huaj nga nxënësit e kësaj moshe shih rezultatin I. 9 (shkalla e parë, f 20).
- Duhet pasur parasysh kriterin se mësimi i gjuhës do kontinuitet, jo një vit të mësohet e një vit të mos mësohet, pastaj prapë të fillohet.
- Duhet pasur parasysh përgatitjen e kuadrit arsimor. A është në gjendje mësuesja e klasës ta mbajë vetë mësimin e gjuhës angleze, apo duhet kuadër i ri?

Ndërsa, sa i përket mësimin të gjuhës amtare, se sa orë mësimore duhet t'i ketë secila klasë e shkallës së parë apo të dytë, është mirë që të bëhet diagnostikimi i përgatitjes dhe përvojës së nxënësve.

***P.sh.,** mësimi i shkronjave, nëse në bazë të analizës së testimit që kemi bërë gjatë regjistrimit të fëmijëve në klasën e parë konsiderojmë se nxënësit nuk i njohin shumicën e shkronjave, mund të vendosim që në gjysmëvjetorin e parë të klasës së parë apo gjatë tërë klasës së parë të ketë numër më të madh të orëve mësimore të gjuhës amtare në klasën e parë sesa në klasën parafillore dhe klasën e dytë.*

Të drejtën e fleksibilitetit të organizimit të orëve mësimore e gëzojnë edhe fushat e tjera kurrikulare, por duhet pasur parasysh çdoherë **mostejkalimin** e numrit të orëve si total të fushës kurrikulare dhe si total të përgjithshëm të të gjitha fushave kurrikulare për javë. Gjithashtu, duhet pasur parasysh **prioritetin** që u japin rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare lëndës mësimore dhe kritere të tjera që janë përcaktuar në Kurrikulën Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor, në faqen 91.

Planin mësimor mesimdhënësit-t e shkollës fillore mund ta bëjnë në **bashkëpunim me kolegët** e klasës së njëjtë, por të paraleleve të ndryshme. Gjithashtu, mund ta bëjnë edhe në mënyrë të pavarur, sepse një mesimdhënës-se është përgjegjëse vetëm për një paralele. Mirëpo, bashkëpunimi gjithherë është më produktiv!

Aktivitet:

Pasi që keni lexuar, diskutuar dhe analizuar udhëzimet e dhëna për planin mësimor, diskutoni me kolegë dhe përgatitni një plan mësimor për të dy shkallët e nivelit të parë të arsimit, shkallën 1 (klasa parafillore, klasat 1 dhe 2) dhe shkallën 2 (klasat 3, 4 dhe 5) dhe përgatitni një arsyetim për ndarjen e orëve në vite .

III.2 Plani i shkallës kurrikulare

- *Rezultate të të nxënit për shkallë - kompetenca (RNSH);*
- *Rezultate të të nxënit për fusha kurrikulare (RNF).*
- *Plani orientues për klasë*

Planifikimi në nivel shkalle kurrikulare (në këtë rast të shkallës së parë dhe të dytë), ndihmon në përcaktimin orientues të procesit mësimor të secilës klasë sa ka shkalla kurrikulare. Gjithashtu, sigurohet kontinuitet nga klasa në klasë dhe bëhet evitimi i përsëritjeve të paplanifikuara.

Si mund të bëhet planifikimi për shkallë kurrikulare?

Në këtë planifikim bëhet identifikimi i rezultateve të të nxënit për shkallë (kompetencave - RNSH) dhe të fushave kurrikulare (RNF) të shkallës përkatëse, se cilat do të jenë në fokus të arritjes për secilën klasë, me qëllim që mos të bëhet mbingarkim i njërës nga klasat e shkallës kurrikulare. Gjithashtu krijohet një pasqyrë e përfshirjes së të gjitha rezultateve të të nxënit për kompetenca dhe fusha kurrikulare brenda shkallës kurrikulare.

Mësimdhënësit në këtë planifikim, nëse e shohin të arsyeshme, mund të parashohin edhe elemente të tjera, p.sh. konceptet e fushës, temat mësimore. Mbi bazën e koncepteve dhe rezultateve të identifikuara mund të përcaktohen temat mësimore (TM) për secilën klasë. Këto tema mund të jenë si pika orientuese për planifikim vjetor. Gjithashtu, më pas, kur bëhet planifikimi vjetor, nëse shihet e arsyeshme, mund të bëhen ndryshime.

Rezultatet e të nxënit të shkallëve kurrikulare - kompetencave, konceptet dhe rezultatet e fushave kurrikulare nëpër klasë, vendosen në origjinal, si janë në Kurrikulën Bërthamë. Mund të ndodhë që rezultatet të barten nga klasa në klasë, por janë temat mësimore që i bëjnë të dallueshme. Për çështje praktike, rezultatet të shkruhen me numra dhe të jenë në një rend me temën e përcaktuar që është në funksion të tyre. Shih shembullin më poshtë në tabelë. Në të njëjtën tabelë mund të bëhet planifikimi edhe i fushave të tjera kurrikulare, në mënyrë që të shihet prezenca e rezultateve të të nxënit për shkallë kurrikulare - kompetenca në të gjitha klasat sa ka shkalla përkatëse.

Shembuj të tabelave të mundshme të planit për shkallë kurrikulare:

Tab.1 **Shkalla e parë**

Klasa e parafillore				Klasa e parë				Klasa e dytë			
RNSH - kompetencë	Konceptet	RNF..... Shoqëria dhe mjedisi	Tema mësimore	RNSH-kompetencë	Konceptet	RNF	Tema mësimore	RNSH-kompetencë	Konceptet	RNF. ...	Tema mësimore
I.4, I.6	Proceset shoqërore	1.1, 1.2	Unë dhe familja								
		RNF... gj. komu				RNF				RNF	

Tab 2. **Shkalla e parë**

Shembull i planit për shkallë vetëm me rezultate të të nxënit për shkallë kurrikulare-kompetenca dhe për fusha kurrikulare.

Fusha kurrikulare	Rezultatet	Klasa parafillore	Klasa I	Klasa II
Gjuha dhe komunikimi	Rezultatet e të nxënit të shkallës/kompetencave p.sh shkalla IV	p.sh rezultati I.1, II.5, III.5 (i njëjtë)	psh. II.1, III.4, III.5 (i njëjtë)	Psh. I.2, III.4 (i njëjtë), V.4
	Rezultatet e të nxënit të fushës	p.sh. rezultat II.1 IV.1, V.3	I.2, IV.2 II.3, IV.1	2.1 5.1, V.1
Matematika		II.5,...		

Gjatë këtij planifikimi mund të shohim se cilat rezultate mendojmë t'i synojmë (përsërisim) nëpër klasë. Në këtë tabelë rezultatet e të nxënit janë vetëm shembuj, ndërlidhja nuk është e saktë. Qëllimi është vetëm të kuptohet ideja se disa rezultate të të nxënit, nëse shihen të arsyeshme, mund të barten nëpër klasë, e disa jo. Gjithashtu, rezultatet e njëjta mund të synohen edhe nga fushat e tjera kurrikulare. Rezultatet e kompetencave, edhe pse barten nga klasa në klasë, në kuadër të fushës së njëjtë kurrikulare, mund të ndërlidhen me rezultate të të nxënit të njëjta apo të ndryshme të fushës kurrikulare.

Sidoqoftë, çfarë lloj planifikimi të bëjë për shkallë kurrikulare mund të vendosë vetë mësuesdhënësi, duke pasur parasysh funksionin e tij të mëvonshëm në planifikimet vjetore për klasat e shkallës së caktuar kurrikulare.

Aktivitet:

Pasi që keni lexuar, diskutuar dhe analizuar udhëzimet e dhëna për planifikimin e shkallës kurrikulare, diskutoni me kolegë të fushës së kurrikulës dhe përgatitni një planifikim për shkallë kurrikulare – në fushën Gjuhët dhe komunikimi.

Niveli I, shkalla e parë (klasa parafillore, klasa 1 dhe 2)

Fusha kurrikulare	Konceptet e përgjithshme të fushës	Rezultatet	Klasa parafillore	Klasa e parë	Klasa e dytë
Gjuhët dhe komunikimi		Rezultatet e të nxënit të shkallës/kompetencave p.sh shkalla I			
		Rezultatet e të nxënit të fushës Gjuhët dhe komunikimi			

III. 3 Plani vjetor

Plani vjetor përmban këto elemente:

- *Konceptet e fushës kurrikulare marrë nga KB për shkallën e caktuar;*
- *Rezultatet e të nxënit për shkallën e caktuar - kompetencat, marrë nga KB;*
- *Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare marrë nga KB për shkallën e caktuar;*
- *Temat mësimore që trajtohen gjatë një viti mësimor. Temat shpërndahen (organizohen) në 5 cikle dymujore.*

Planifikimi vjetor është dokument, i cili e orienton zhvillimin e mësimin për një vit shkollor (mësimor), duke i përmbushur kërkesat e shkallës kurrikulare dhe duke i ndarë apo duke i thjeshtuar për klasën e caktuar. Ai hartohet për secilën fushë kurrikulare dhe ka për qëllim identifikimin e rezultateve të të nxënit të kompetencave, të cilat mund të jenë si synim arritjeje gjatë një viti shkollor (mësimor), identifikimin e koncepteve dhe rezultateve të të nxënit të fushave kurrikulare nga të cilat do të përcaktohen përmbajtjet mësimore. Ky planifikim mbështetet në planifikimin për shkallë kurrikulare, por edhe kërkon konsultë të vazhdueshme të KB-së, respektivisht të shkallës së caktuar kurrikulare.

Si bëhet planifikimi vjetor?

Shembull, hapat që duhet ndjekur për planifikim vjetor, klasa e parë.

Hapi 1	hapi 2	hapi 3	Hapi 4
Konceptet	RNF	Tema mësimore	RNSH –kompetencat
Proceset shoqërore	I Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes apo të përfshirjes në to <i>I.1 Tregon për vetveten, familjen e ngushtë dhe të gjerë (dallon moshën dhe prejardhjen), organizimin e hapësirës së banimit dhe veprimit, lëvizjet natyrore të popullsisë, migrimet, vendbanimet dhe veprimtaritë ekonomike.</i>	Unë dhe shoqëria <i>(familja, shkolla, komuniteti veprimtaritë ekonomike, puna dhe profesionet, festat dhe traditat, vlerat dhe qëndrimet, sjelljet).</i>	I.1, I.3,V.5, VI.1, ...

Kjo i mbetet mësimdhënësit-set të vendosë se me çfarë hapa të bëjë planifikimin. Ata-ato mund të planifikojnë duke i ndjekur hapat si në tabelën më lart, por edhe mund të vendosin që hapin e 4 ta vendosin të parin e pastaj për të vijuar me hapat 1, 2 dhe 3 (RNSH-kompetenca, koncepte, RNF dhe tema mësimore).

Përmbajtja mësimore duhet të jetë në funksion të mësimdhënies se integruar brenda fushës kurrikulare, por edhe të fushave të tjera kurrikulare. Puna me tema të përbashkëta mësimore brenda fushës kurrikulare dhe lidhshmëria me temat mësimore të fushave të tjera kurrikulare janë në linjë të mësimdhënies dhe të nxënies së integruar.

Temat mësimore janë tërësi mësimore, të cilat mbulojnë apo përfaqësojnë të gjitha lëndët mësimore brenda një fushe kurrikulare.

Shembull, edhe pse fusha e kurrikulës Gjuhët dhe komunikimi përbëhet prej dy lëndëve mësimore, Gjuhës amtare dhe Gjuhës së huaj, temë e përbashkët mund të jetë **Kultura e komunikimit**, dallimi në klasë të parë është se në gjuhën amtare mësohen shkronjat fjalë, fjali dhe krijohen tekste të shkurtra, ndërsa në gjuhën e huaj mësohen fjalë të thjeshta, duke mos mësuar shkrim-lexim.

Gjatë identifikimit të rezultateve të të nxëniet të fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi dhe Artet mësimdhënësit mund të hasin në rezultate që anojnë te një lëndë mësimore dhe në këtë rast ndonjë temë mësimore mund t'i dedikohet vetëm një lëndë mësimore. Por, është qasje e KKK drejt mësimdhënies dhe nxënies së integruar, andaj duhet synuar përcaktim të temave mësimore, të cilat janë reprezentative për të gjitha lëndët mësimore brenda fushës kurrikulare.

Temat mësimore mund të jenë prezent disa muaj gjatë vitit shkollor (mësimor), por mund të ketë raste që të jenë prezent edhe gjatë tërë vitit shkollor. Kjo varet nga nevojat e nxënësve dhe nga rezultatet e të nxëniet të fushës kurrikulare. Shih shembullin në fushën kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi, respektivisht gjuhën amtare në klasën e parë.

Shembull:

Shpërndarja e temave mësimore gjatë dy muajve

Koncepti	RN	Tema	IX-X
Gjuha figurative dhe jofigurative; Sistemi i gjuhës; F 34 KB	<u>1,1.1,1.2</u> , 3.1, 4.1 KB –FQ 35-37	Periudha parapërgatitore e abetares	√

Shpërndarja e temës mësimore gjatë tërë vitit mësimor

Koncepti	RNF	Tema	IX - X	XI-XII	I-II	III-IV	V-VI
Tekstet letrare dhe joletrare	I.1,I.3,II.2,III.1,V.1, VI.1 KB –FQ 35-37	Përpunimi i shkronjave	√	√	√	√	√

Me rastin e përzgjedhjes të temave mësimore duhet pasur parasysh përvojat, interesat dhe mundësitë e nxënësve.

Shembull, në klasën parafilllore në shkencat shoqërore fillohet me tema që janë më të afërta me nxënës-e, tema të cilat lidhen me përditshmërinë e jetës së tyre dhe aktualitetin shoqëror, si temat Unë dhe familja, Shkolla ime, për të vazhduar më pas me Mjedisin shoqëror. Apo p.sh. në matematikë në klasën e katërt të mos startohet me pjesëtim, sepse konsiderojmë se ende duhet forcuar shumëzimi si veprim matematikor.

Preferohet që në tabelën e planifikimit vjetor të vendosen të gjitha fushat kurrikulare, në mënyrë që lidhshmëria ndërfaqshore të jetë sa më e pranishme dhe gjithashtu kontrollimi i përfshirjes së rezultateve të të nxënimit për shkallë kurrikulare (kompetenca). Kjo na mundëson të kemi një pasqyrë të saktë të rezultateve të të nxënimit të shkallëve kurrikulare (kompetencave).

Udhëzime për plotësim të tabelës

- Ky format i tabelës së planit vjetor përdoret për të hartuar planin për secilën klasë;
- Plani për të gjitha fushat kurrikulare të jetë i shkurtër dhe i qartë. Kjo formë e planifikimit u mundëson të gjitha fushave kurrikulare të kenë qasje të njëra-tjetra dhe hetohet që në shikim të parë.

- Me rastin e hartimit të temave mësimore merren për bazë konceptet e fushës kurrikulare dhe rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare (RNF). Ato merren nga Kurrikula Bërthamë për shkallë. Konceptet e fushës kurrikulare janë të vlefshme për gjithë shkallën, përkatësisht për gjithë arsimin parauniversitar (shih KB - fushat e kurrikulës), por mësuesi mbi bazën e këtyre koncepteve duhet të seleksionojë temat për secilën klasë, sa ka shkalla.

- Në kolonën e emërtuar **Konceptet e fushës kurrikulare;**
- Shënohen vetëm ato koncepte, të cilat trajtohen në klasën e caktuar, por të gjitha ato domosdoshmërisht duhet trajtuar gjatë shkallës kurrikulare. Konceptet merren nga KB, f. 34;
- Në kolonën e emërtuar **Rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare** vendosen rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temë mësimore, pra vetëm ato nga të cilat dalin temat mësimore - origjinale marrë nga KB;
- Në kolonën e emërtuar **Temat mësimore që trajtohen gjatë një viti mësimor për secilin fushë kurrikulare** shënohen të gjitha temat mësimore që do të trajtohen brenda një viti shkollor (mësimor). Temat mësimore përbëhen prej disa njësive mësimore. Në këtë tabelë shkruhen vetëm temat, e jo njësitë mësimore. Temat mësimore janë të vlefshme për të gjitha lëndët që i ka një fushë. Njësitë mësimore janë ato që i bëjnë të dallojnë lëndët brenda fushës së njëjtë kurrikulare. Njësitë mësimore, edhe pse janë të ndryshme nga lënda në lëndë, brenda fushës kurrikulare synojnë temën e përbashkët, secila prej këndit të lëndës së vet.
- Në kolonën e emërtuar **Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve** bëhet shpërndarja e temave të përzgjedhura për një vit mësimor nëpër muaj.

Në shtrirjen dymujore temat zbërthen me më pak fjalë se çfarë do të trajtohet brenda tyre (shumë shkurt - ndoshta në formë të nëntemave, me disa sqarime, por në formë të pyetjeve-aktiviteteve).

P.sh., shih konceptet e fushës kurrikulare Shoqëria dhe mjedisi, tema mësimore e mundshme Unë dhe shoqëria, ndërsa nëntema Unë dhe familja, Unë dhe shkolla,...sepse pjesë e shoqërisë jam unë, është familja. Ne mund të mendojmë edhe në atë se si është organizuar familja – e ngushtë e gjerë? Çfarë rregulla ka në familje? Çfarë përgjegjësi - të drejta, ka secili anëtar i familjes dhe unë? Si merren vendimet? Mjedisi kë ka komshi, cilat institucione janë afër, prejardhja e familjes (vendi i prejardhjes)? etj.

Brenda dy muajsh mund të jenë disa tema mësimore, 1, 2 tema apo më shumë, varësisht sa mësuesi mendon se janë të nevojshme të trajtohen brenda muajve (preferohet numri i vogël i temave). Disa

tema mund të jenë prezente edhe në muajt e tjerë, kuptohet me njësi të reja mësimore. Renditja e temave nëpër muaj sugjerohet të bëhet sipas një rendi logjik.

- Në kolonën rezultatet e të nxënimit për shkallë kurrikulare – kompetenca shkruhen vetëm rezultatet për kompetenca që mendohet se duhet të arrihen përmes temave për secilën fushë. Këto rezultate mund t'i gjeni te rezultatet e të nxënimit të shkallëve kurrikulare.

Në këtë kolonë rezultatet i shënoni me numra rendorë, ashtu origjinale, si janë në KB.

Mësuesi i përcakton se cilat kompetenca – rezultate të të nxënimit për shkallë - kompetenca synon t'i arrijë përmes fushës kurrikulare gjatë një viti mësimor, respektivisht përmes temës mësimore.

Bashkërisht të gjitha fushat kurrikulare për sa klasë që ka shkalla duhet synuar të arrijnë të gjitha rezultatet e kompetencave, d.m.th. nëse shkalla i ka tri klasë atëherë për tri vite shkollorë-mësimore një gjeneratë që i takon shkallës së caktuar duhet t'i arrijë të gjitha rezultatet e kompetencave të parapara për shkallën e caktuar në Kurrikulën Bërthamë.

Mësimdhënësit duhet të vendosin se cilat nga rezultatet e të nxënimit për shkallë të parë - kompetencë do t'i synojë t'i arrijë në klasën parafillore, cilat në klasën e parë dhe cilat në klasën e dytë.

Ka raste kur një rezultat i ndonjë kompetence mund të synohet të arrihet në dy klasë apo tri radhazi, kjo i mbetet mësimdhënësit të vendosë. **Kujdes, rezultatet duhet të arrihen nga secili nxënës.**

Procedurat e nevojshme për plotësim të tabelës

- Në shkallën e parë dhe të dytë të klasës parafillore dhe arsimit fillor **punojnë të gjithë mësimdhënësit-et** e paraleleve sa i ka klasa e caktuar (Këshilli i klasës). Në këtë grup duhet të kontribuojnë përfaqësuesit e secilës fushë kurrikulare të shkollës së mesme të ulët.
- Pasi që të bëhet planifikimi vjetor për secilën fushë kurrikulare për klasën e caktuar, atëherë mësimdhënësit-et e klasës së caktuar bashkërisht duhet të diskutojnë lidhshmëritë e fushave kurrikulare me njëra-tjetrën dhe më pas t'i vendosin në formatin e përbashkët të tabelës të gjitha planifikimet vjetore të fushave kurrikulare.

Pra, diskutimet duhet të jenë në lidhshmërinë e fushave kurrikulare, respektivisht përmbajtjeve - temave mësimore dhe rezultateve të të nxënimit për shkallë kurrikulare -kompetenca që synojnë t'i arrijë secila fushë kurrikulare.

Aktivitet:

Pasi që keni lexuar, diskutuar dhe analizuar udhëzimet e dhëna për PLANIFIKIMIN VJETOR , diskutoni me të Këshillit të klasave dhe përgatitni një plan vjetor për një fushë të kurrikulës, finalizoni atë dhe vazhdoni me planifikimin vjetor në fushat tjera të kurrikulës.

III.4 Plani dymujor

Planifikimi dymujor përmban këto elemente:

Temat mësimore, RNSH (kompetenca), RNF, korrelacionin dhe çështjet ndërkurrikulare, lëndën mësimore, RNL, njësitë mësimore, kohën e nevojshme, metodologjitë e mësimdhënies, vlerësimin dhe burimet.

Si bëhet planifikimi dymujor?

Plani dymujor është vazhdimësi e plani vjetor të procesit mësimor dhe si tërësi e këtyre planifikimeve ka formatin e një programi mësimor. Gjatë një viti shkollor (mësimor) bëhen pesë planifikime dymujore. Ky planifikim hartohet për dy muaj dhe vetëm për një temë mësimore. Kjo do të thotë nëse në planifikim vjetor është paraparë që brenda dy muajve të trajtohen dy tema mësimore, atëherë duhet bërë dy planifikime dymujore për muajt e njëjtë. Planifikimi mund të bëhet në të njëjtin formular- tabelë, vetëm me vazhdime.

Plani dymujor ka për qëllim zbërthimin e temave mësimore të fushës së përbashkët kurrikulare në njësi mësimore nga lëndët mësimore. Njësitë mësimore bashkërisht duhet të kenë për synim arritjen e rezultateve të identifikuar të të nxënimit të shkallës kurrikulare (kompetencave) dhe të fushës kurrikulare të synuara të arrihen nga tema e caktuar mësimore. Gjithashtu, planifikimi dymujor ka për qëllim identifikimin e rrugëve (metodologjisë), mjeteve (materialeve) dhe burimeve për arritjen dhe vlerësimin e nivelit të arritjes së këtyre rezultateve. Elementet e planifikimit dymujor shihen në tabelën e emërtuar **Plani dymujor i procesit mësimor**.

Tema mësimore e përzgjedhur mund të ketë lidhshmëri edhe me temat mësimore të fushave të tjera kurrikulare. Këtë lidhshmëri duhet shikuar në planifikimin e përbashkët vjetor me fushat e tjera kurrikulare, me qëllim që të bëhet pjesë e planifikimit dymujor dhe kështu të mundësohet mësimdhënia dhe të nxënimit e integruar.

***P.sh.**, tema mësimore Mjedisi (orientimi në hapësirë) e shkencave natyrore mund të ndërlidhet me fushën e Matematikës, përkatësisht me temën mësimore Kahet e lëvizjes (që trajton elementet para, mbrapa, lart, poshtë, majtas, djathtas) me fushën e Shëndetit dhe mirëqenies, me temën Ecja dhe me fusha të tjera kurrikulare.*

Po ashtu, pjesë e planifikimit mund të jenë çështjet ndërkurrikulare, si të drejtat e njeriut, çështjet gjinore..., të cilat mund të korrespondojnë me temën e përzgjedhur. Shih pjesën çështjet ndërkurrikulare në KB - në përmbajtjen e secilës fushë kurrikulare.


***P.sh.**, nëse për temë mësimore në fushën kurrikulare Shoqëria dhe mjedisi për dy muaj trajtojmë familjen, atëherë mund të ndërlidhemi me çështjet gjinore sa u përket përgjegjësi në familje. Diçka të tillë mund të bëjmë edhe në fushat e tjera, e pse jo edhe në matematikë.*

Planifikimi dymujor i temës mësimore u mundëson lëndëve mësimore të një fushe kurrikulare, përmes njësive mësimore, arritjen e përbashkët të rezultateve të kompetencave dhe të fushës kurrikulare, por secilës nga këndi i vet.

Zbërthimit të temës mësimore në njësi mësimore duhet t'i paraprijë zbërthimi i rezultateve të fushës kurrikulare në rezultate të të nxënit për lëndë mësimore për klasën e caktuar, aty ku fusha kurrikulare realizohet përmes lëndëve mësimore (shih fushat Gjuhët dhe komunikimi dhe Artet). Ndërsa, te fushat kurrikulare të cilat e kanë statusin edhe të fushës kurrikulare edhe të lëndës mësimore zbërthimi i rezultateve të të nxënit bëhet për klasë.

Mësimdhënësi-ja gjatë zbërthimit të rezultatit të fushës në rezultatet e të nxënit për lëndë – klasë, mund të shfrytëzojë planet dhe programet ekzistuese apo rezultatet përfundimtare marrë nga tabela krahasuese e rezultateve të fushës kurrikulare të KB-ve me rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese për shkallën e parë, apo të dytë, të cilën e ka krahasuar vetë (shih materialin më lart, pjesën II. 3.3, rezultatet e të nxënit për klasë në nivel të fushës kurrikulare apo lëndës mësimore –RNL, brenda shkallës kurrikulare). Nga kjo tabelë mund të zgjidhen vetëm ato rezultate që janë në funksion të rezultatit të fushës nga i cili është dalë tema mësimore. Në të kundërtën, mësimdhënësi-ja mund edhe t'i hartojë vetë. Pas shkrimit të rezultateve të lëndës mësimore (fushës kurrikulare) për klasë përcaktohen njësitë mësimore.

Shih skemën e zbërthimit të rezultateve të fushës kurrikulare (RNF) në rezultate të të nxënit për lëndë për klasë (RNL), nga të cilat dalin temat mësimore (TM) dhe njësitë mësimore (NJM) dhe shembullin e procesit të përcaktimit të njësive mësimore.



Shembull: Procesi i përcaktimit të njësive mësimore

Hapi 1	hapi 2	hapi 3	Hapi 4	Hapi 5
RNSH (kompetenca)	RNF- gjuhë dhe komunikim	Tema mësimore	RNL	Njësia mësimore
I. Komunikues efektiv 1.1 Lexon me zë një tekst të palexuar me parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.	I, I.2, Flet disa fjalë apo fjali, bën pyetje dhe përgjigjet duke përdorur fraza apo fjali të thjeshta, të përsëritura. I.2.1 Përdor strategji për të lexuar me kënaqësi tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë si dhe elementet e përdorimit të gjuhës.	Kultura e komunikimit – elementet (tingujt – shkronjat)	1. Lexon fjalë dhe fjali qartë dhe saktë që kanë në përbërje shkronjat e mësuara –p.sh. Rr . 2. Shpjegon domethënien e fjalëve dhe fjalive të lexuara në tekstin e dhënë si detyrë, p.sh. që kanë në përbërje shkronjën Rr.	Tingulli dhe shkronja Rr e shtypit dhe e dorës (Lexim fjalësh dhe fjalish).

Përzgjedhja e njësive mësimore dhe temat mësimore duhet të jenë në pajtim me përvojat, mundësitë, interesat e nxënësve, të ndërlidhura me jetën dhe të jenë aktuale.

Tabela e planit dymujor të procesit mësimor

Fusha:
Klasa:
Muajt: shtator - tetor
Tema mësimore:.....

Rezultatet e kompetencave që synohen të arrihen përmes temës:
Rezultatet e fushës kurrikulare që synohen të arrihen përmes temës:
Korrelacioni me fushat kurrikulare dhe çështjet ndërkurrikulare:

Fusha apo Lëndët mësimore	Rezultatet e të nxënësve të lëndës	Njësitë mësimore	Koha e nevojshme	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burimet

Udhëzime për plotësim të pjesës narrative dhe tabelës

Pjesa narrative Planifikimi

Plani dymujor, sipas këtij formulari, bëhet për një temë mësimore. Nëse brenda dy muajve në planifikim vjetor janë paraparë dy apo më shumë tema, atëherë duhet për secilën temë të bëhet planifikimi. Planifikimi mund të bëhet në të njëjtin formular (tabelë), me vazhdimë.

Secila lëndë e fushës duhet të pasqyrohet në tabelën e përbashkët për temën e përbashkët.

Temat mësimore

Tema mësimore merret nga tabela e planifikimit vjetor të temave për fusha të kurrikulës sipas planifikimeve për dy muaj.

Rezultatet e të nxënit për shkallë - të kompetencave

Nga kompetencat që janë paraparë të arrihen te planifikimi vjetor - marrë nga KB, barten vetëm ato rezultatet të të nxënit për shkallë - kompetenca që synohen të arrihen përmes temës mësimore - përmes lëndës mësimore. Tani rezultatet shkruhen me numra rendorë dhe me narracion, si janë në KB. Mund të jenë një, dy apo më shumë rezultate.

Rezultatet e fushës kurrikulare

Shënohen vetëm ato rezultate të të nxënit të fushës kurrikulare që synohen të arrihen përmes temës së caktuar mësimore nga lënda mësimore e fushës së caktuar. Rezultatet duhet të merren nga planifikimi vjetor që janë marrë nga KB - shkalla e caktuar kurrikulare. Mund të jenë një, dy apo më shumë rezultate. Është mirë që për çështje praktike edhe rezultateve të fushave kurrikulare t'u vendosen numrat rendor të njëjtë, ashtu si u kemi vendosur në planifikimin vjetor. Gjithashtu, t'u shkruhet edhe narracioni, siç janë në KB.

Korrelacioni dhe çështjet ndërkurrikulare

Korrelacioni bëhet mbi bazën e planifikimit vjetor të fushave kurrikulare. Me pak fjalë përshkruani korrelacionin e temës që planifikohet me temat e fushave të tjera. Duhet të bëhet ndërlidhja e temës mësimore me çështjet ndërkurrikulare, si të drejtat e njeriut, toleranca,... shih KB - çështjet ndërkurrikulare.

Plotësimi i tabelës

Lëndët mësimore

Shënohen lëndët mësimore që janë në kuadër të fushës kurrikulare dhe që trajtojnë temën e përbashkët, por secila nga këndi i vet.

Rezultatet e të nxënit të lëndës mësimore

Mësimdhënësi-sja i shkruan rezultatet e të nxënit të lëndës mësimore nga të cilat dalin njësitë mësimore. Në këtë rast mund t'i konsultojë - marrë nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me KB. Mund të jenë një, dy, apo më shumë rezultate. Por, edhe mund t'i hartojë vetë. Një rezultat i të nxënit të lëndës mësimore, mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore, e gjitha varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënit dhe nga elementet përbërës të rezultatit.

Secilit rezultatet të të nxënit të lëndës t'i vendoset një numër rendor.

Njësitë mësimore

Njësitë mësimore shënohen për lëndë mësimore. Mësimdhënësi-ja përcaktohet për ato njësi mësimore që dalin nga rezultatet të të nxënit të lëndës mësimore për klasë dhe që janë në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit të fushës dhe kompetencave të caktuara për temën e përbashkët të fushës kurrikulare.

Koha e nevojshme

Mësuesi duhet të konsultojë planin mësimor që e ka zbërthyer nga KB për klasë. Ai vendos sa kohë (orë mësimore) i nevojitet, përmes njësive mësimore, të arrihen rezultatet e të nxënit të lëndës mësimore, zhvillimit të kompetencave të caktuara të nxënësit (arritshmërinë e rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare dhe kompetencave).

Metodologjia

Të shkruhet në formë të aktiviteteve, duke i përmendur metodat dhe teknikat e mësimdhënies dhe të të nxënës, jo shumë të detajuara, sepse kjo bëhet në planin e orës mësimore.

Vlerësimi

Vlerësimi të paraqitet në formë të aktiviteteve dhe me çfarë instrumente bëhet ai. P.sh. test, ese, listë kontrolli, pyetësor etj.

Burimet

Të shkruhen burimet që mësimdhënësi dhe nxënësit i shfrytëzojnë për arritjen e rezultateve të caktuara. Ato mund të jenë të ndryshme (burimet e shkruara, elektronike, njerëzore etj.).

Burimet e shkruara mund të jenë tekste mësimore, gazeta, revista, dokumente dhe materiale të ndryshme.

Burimet elektronike, interneti, ueb-faqja, TV-kanali-emisioni, radio.

Burimet njerëzore mund të jenë njerëzit që janë pjesë e një historie, ngjarje, pune etj.

Sugjerim

Një planifikim i mirë kërkon bashkëpunim brenda aktiveve profesionale, Këshillit të klasës!

Shembull i plotësimit të tabelës së planit dymujor

Lëndët mësimore	Rezultatet e të nxënës të lëndës	Njësitë mësimore	Koha e nevojshme	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burimet
Gjuhë shqipe	1. Lexon fjalë dhe fjali qartë dhe saktë që kanë në përbërje shkronjat e mësuara –p.sh. Rr . 2. Shpjegon domethënien e fjalëve dhe fjalive të lexuara në tekstin e dhënë si detyrë , p.sh. që kanë në përbërje shkronjën Rr.	Tingulli dhe shkronja Rr (grafiku i shtypit)	3 orë	Bashkëbisedu ese, Demonstrues e Audiovizuale, vizuale	Ngjyrat e semaforit',...	Abetarja, fletore pune,video incizim, fletat me ngjyra
Gjuhë angleze						

Këto dy kolona, e mësimdhënies dhe e vlerësimit, është mirë të shoqërohen me aktivitete praktike. Nëse nuk bëhen këtu, atëherë të planifikohen në planin e orës mësimore.

Aktivitet:

Pasi që keni lexuar dhe analizuar udhëzimet e dhëna për **PLANIFIKIMIN DYMUJOR**, diskutoni me kolegë të këshillit të klasës dhe përgatitni një plan dymujor sipas fushave të kurrikulës.

III.5 Plani javor

Meqenëse plani dymujor nuk është i ndarë në javë, plani javor mundëson përcaktimin e njësive mësimore, të cilat do të realizohen gjatë javës për secilën lëndë mësimore (fushë kurrikulare) në klasën e caktuar. Njësitet mësimore merren nga planifikimi dymujor.

Planifikimi javor ka për qëllim lidhshmërinë e njësive mësimore të lëndëve të ndryshme mësimore në kontekst të kuptimit të situatave, problemave, dukurive dhe ngjarjeve, si çështje të ndërlidhura e jo të ndara.

Si bëhet planifikimi javor?

Mësuesit e klasës parafillore dhe arsimit fillor planifikimin javor mund ta bëjnë në formë tabelare, ngjashëm si faqja e ditarit (librit të klasës) që e ka secila klasë, ku shënohen orët mësimore për çdo ditë, sipas orarit.

Tabela nuk ka nevojë të ngarkohet me elemente të tjera, sepse këto veç janë përgatitur në planin dymujor dhe më pas zërthehen në planin e orës mësimore.

Shembull i një formati të mundshëm të planifikimit javor (klasa e parë)

Tema pikënisëse: **Udhëtimet dhe aventurat**

Dita	Njësitet mësimore në javë				
E hënë	1. Gjuhë dhe komunikim	2. Gjuhë dhe komunikim	3. Matematikë	4. Artet Ed. figurative	Gjatë kësaj jave do të diskutohet për udhëtimet dhe aventurat , p.sh. në fushën Shoqëria dhe mjedisi , e cila do të jetë pikë referimi i fushave të tjera kurrikulare si: Matematikë –Gjatë punës me libër kemi ilustrime të trenit, zhytësit. Numërimi i vagonëve të trenit,.. Gjuhë dhe komunikim: Zhvillimi i shkronjës dhe tingullit H dhe T (hëna,treni,helikopteri) Shkencat e natyrës Gjatë orës mund të diskutojmë për mjetet e udhëtimit se kur lëvizin për sa mund të lëvizin prej një vendi në vendin tjetër etj Jeta dhe puna –
	Lexim në abetare f. 45	Paraqitja e tingullit dhe shkronjës H,h. Grafiku I shtypit f. 46	Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 9 F. pune f.36	Vizatojmë:Trenin, topin, hënë	
E martë	1. Matematikë	2. Gjuhë dhe komunikim	3. Gjuhë dhe komunikim	4. Shoqëria dhe mjedisi	
	Zbatime të mbledhjes dhe zbritjes me problem f. 54	Shkronja e madhe dhe e vogël H,h (grafiku I dorës) f. 47	Anglisht	Mjetet e udhëtimit	
E mërkurë	1. Matematikë	2. Artet Ed. muzikore	3. Gjuhë dhe komunikim	4. Zgjedhore-Lexim shkrimi	
	Numri 10 f. 57	Mësohet kënga Tapshin tapshin	Plotësim në Abetare pune f.36	Diktim	
E enjte	1. Gjuhë dhe	2. Matematikë	3. Shkencat e natyrës	4. Shëndeti dhe	

	komunikim			mirëqenia	Diskutojmë për rregullat në trafik të mjeteve të udhëtimit (rregulla të thjeshta) Shëndeti dhe mirëqenia : Luajmë lojën ‘Treni’, ku fëmijët imitojnë zhurmën e trenit dhe renditen si lokomotivat.
	Lexim dhe plotësim në abetare f .47	Numrat prej 1 – 10 f .58	Matja e kohës:ora,dita,nata	Loja e trenit	
E premtë	1. Gjuhë dhe komunikim	2. Matematikë	3. Jeta dhe puna	4. Shëndeti dhe mirëqenia	
	Paraqitja e tingullit dhe shkronjës T,t. Grafiku I shtypit f .48	Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 10	Trafiku f. 13 (punëdore)	Orientimi në natyrë	

Aktivitet:

Pasi që keni lexuar dhe analizuar udhëzimet e dhëna për PLANIFIKIMIN JAVOR diskutoni me kolegë të këshillit të klasës dhe përgatitni një plan javor sipas fushave të kurrikulës.

III.6 Plani i orës mësimore

Plan i orës mësimore ka për qëllim që të gjitha planifikimet e procesit mësimor t’i bëjë të zbatueshme në punën e drejtpërdrejtë me nxënësit-et në klasë, por edhe jashtë saj brenda një ore mësimore.

Çfarë duhet të përmbajë plani i orës mësimore?

Në këtë planifikim mësimdhënësi-ja përcakton:

- Njësinë mësimore, të cilën do ta realizojë (njësia mësimore merret nga planifikimin dymujor, përkatësisht planifikimin javor);
- Rezultatet e të nxënit të synuara për shkallë-kompetenca (të cilat i ka përcaktuar në planifikimin dymujor të temës mësimore);
- Rezultatet e të nxënit të synuara të fushës kurrikulare (mund të vendosen vetëm rezultatet e lëndës mësimore që korrespondojnë me rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare - edhe këto merren nga planifikimi dymujor);
- Kriteret e suksesit, të cilat duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Të gjitha rezultatet e kompetencave, të fushave kurrikulare dhe të lëndëve mësimore, duhet të shënohen me numra rendorë të njëjtë, si janë në planifikimin vjetor, e më pas në planifikimin dymujor, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të saktë të realizimit, përkatësisht arritshmërisë së tyre.

Mbi bazën e rezultateve të kompetencave dhe të fushës kurrikulare, mësimdhënësi-ja e elaboron orën mësimore, duke përcaktuar edhe elemente të tjera, të cilat i sheh të nevojshme. Mënyra organizative e orës mësimore - metodologjia e mësimdhënies dhe e vlerësimit, metodat, teknikat, mjetet dhe burimet që shfrytëzohen për realizim të njësisë mësimore duhet të jenë në funksion të rezultateve të të nxënit, të planifikuara për arritje.

Mësimdhënësi mund të përdorë formate të ndryshme të planifikimit të orës mësimore, por çdoherë duhet pasur parasysh rezultatet e të nxënit të kompetencave dhe të fushave kurrikulare. Shih format e mundshëm të planit mësimor.

Shembull: Plan i orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: / Lënda:	Shkalla e kurrikulës: / Klasa:
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës:	
Tema / njësia mësimore:	
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën ____:	Mund të shkruhen rezultatet e synuara me numër dhe shumë shkurt elementet e kësaj njësie apo aktivitet brenda orës që kontribuojnë në arritshmërin e rezultateve të synuara
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën ____:	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fjalët kyçe:	
Rezultatet e të nxënit:	
Kriteret e suksesit:	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore :	
Përdorimi i TIK:	
Çështjet e ndërlidhura:	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Pjesa hyrëse:	
Pjesa kryesore:	
Pjesa përfundimtare dhe vlerësimi i të nxënit:	
Vetëvlerësim i orës mësimore nga mësimdhënësi	

Më poshtë, te pjesa e metodologjisë së mësimdhënies, shih shembullin e planit të orës mësimore i plotësuar, por me disa elemente më ndryshe nga modeli i planit mësimor më lart.

Aktivitet:

Pasi që keni lexuar dhe analizuar udhëzimet e dhëna për PLANIN E ORËS MËSIMORE diskutoni me kolegë të kësaj njësie dhe përgatitni 2-3 plane të njësisë mësimore, në fusha të ndryshme të kurrikulës.

III.7 Çështjet ndërkurrikulare (çështjet ndërlëndore) dhe korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare

Çështjet ndërkurrikulare paraqesin përmbajtje të rëndësishme kurrikulare, të cilat nuk i takojnë ekskluzivisht vetëm një lënde. Ato realizohen përmes lëndëve të ndryshme kurrikulare (mësimore) dhe janë në funksion të zhvillimit të kompetencave, respektivisht të arritshmërisë së rezultateve të të nxëniet për shkallë kurrikulare. Përmbajtjet e tyre dalin nga edukimit për paqe, të drejta e njeriut, edukimi ndërkulturor, shkathtësitë e komunikimit, çështjet gjinore dhe edukimi qytetar, duke përfshirë edhe ndërgjegjësimin për ruajtjen dhe kujdesin e mjedisit dhe edukimin për karrierë.

Si realizohen çështjet ndërkurrikulare (çështjet ndërlëndore)?

Çështjet ndërkurrikulare mund të integrohen në kurrikulë nëpërmjet njësive tematike dhe njësive mësimore, nëpërmjet aktiviteteve praktike në klasë, por edhe projekteve të përbashkëta që ndërlidhin fushat kurrikulare.

Kështu, me rastin e përzgjedhjes së përmbajtjeve mësimore në fusha të caktuara kurrikulare këto çështje duhet të merren parasysh. Shih *planin mësimor të pjesa e IV.1 Metodologjia e mësimdhënies, kur flitet për Bimët të fusha kurrikulare Shkencat e natyrës. Njësia mësimore e përzgjedhur për bimët mund të jetë edhe në funksion të ndërgjegjësimin për mjedisin, duke kontribuar në ruajtjen dhe kultivimin e tyre. Në këtë rast ndihmojmë nxënësit në arritjen e kompetencës kontribuues produktiv, respektivisht të rezultatit IV.6 të shkallës së parë kurrikulare.*

Gjithashtu, gjatë planifikimit preferohet që këtyre temave t'u jepet hapësirë e veçantë në data të caktuara, si p.sh. Ditës së tokës, Ditës së drejtave të fëmijëve, etj.

Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare mund të bëhet edhe përmes projekteve hulumtuese dhe projekteve të natyrave të ndryshme, p.sh. projekteve promovuese (të vlerave shoqërore, produkteve), projekteve parandaluese etj. Për realizimin e këtyre projekteve mund të kontribuojnë disa fusha kurrikulare, p.sh. në hulumtimin e shkeljes së të drejtave të fëmijëve mund të kontribuojnë fushat kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi përmes mënyrës së shkrimit dhe prezantimit të hulumtimit; Matematika përmes analizave matematikore të të dhënave; Shkencat e natyrës përmes trajtimit të materialeve të dëmshme, si kimikalet gjatë punëve që bëjnë fëmijët në kopsht; Shëndeti dhe mirëqenia përmes trajtimit të shëndetit fizik dhe emocional; Shoqëria dhe mjedisi përmes analizës së konventave të fëmijëve; Jeta dhe puna përmes trajtimit të rreziqeve në punë, pastaj përdorimi i teknologjisë elektronike për hulumtim dhe prezantim dhe gjithashtu rreziqet nga përdorimi i teknologjisë elektronike (Facebook-ut...).

Si realizohet korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare?

Suksesi i gjithë zbatimit të KB qëndron në trajtimin e integruar të temave mësimore nga kënde të ndryshme të fushave kurrikulare. Kjo iu mundëson nxënësve të kuptojnë funksionimin e jetës gjithnjë e më shumë të ndërlidhur.

Realizimi i korrelacionit bëhet në të gjitha planifikimet mësimore, p.sh. në planifikimin për shkallë, në mënyrë studiuëse bëjmë shpërndarjen e RNSH dhe RNF për secilën klasë. Në planifikimin vjetor përcaktojmë tema mësimore që janë në funksion të të gjitha lëndëve mësimore sa ka fusha kurrikulare. Gjithashtu, kërkohet që planifikimet vjetore të të gjithave fushave kurrikulare të vendosen në formatin e njëjtë, me qëllim të funksionimit të korrelacionit në mes tyre. Në planifikimet vjetore vetëm kërkohet të shkruhet korrelacioni dhe kështu vijmë te planifikimi javor, i cili për qëllim ka pikërisht korrelacionin ndërmjet fushave kurrikulare, përkatësisht lëndëve mësimore (shih më lart udhëzuesin, pjesën III. 5 Plani javor). Kjo ndërlidhje më pas reflektohet edhe në orën mësimore, shih shembujt në vijim:

Ndërlidhja e Gjuhës shqipe me fushat e tjera kurrikulare

Lënda: Gjuhë shqipe

Klasa: I

Njësia mësimore: Përpunim i shkronjës Ç

Ndërlidhja kurrikulare me Matematikën (elementet e bashkësisë - mund të jenë fjalë, objekte që fillojnë me shkronjën Ç), me artet (ilustrimi çekiçit, këngë për shkronjën Ç), Jetën dhe punën (mëson rëndësinë e veglave të punës).

IV. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES, MATERIALET MËSIMORE, VLERËSIMI DHE INSTRUMENTET E SAJ

Metodologjia e mësimdhënies

Materialet mësimore

Metodologjia e vlerësimit

Bashkëpunimi i mësimdhënësve

IV.1 Metodologjia e mësimdhënies në funksion të zbatimit të KKK-KB

Pasi që kem bërë planifikimin me kohë dhe të thuktë të KB-ve, duke e zbërthyer atë për nevojat dhe mundësitë e nxënësve, atëherë veç fillojmë realizimin praktik të saj. Kjo do të thotë se ne kem bërë planifikimin për shkallë kurrikulare, planifikimin vjetor dhe dymujor të procesit mësimore, planifikimin javor dhe të orës mësimore dhe i kemi ndërlidhur ato në mënyrë logjike dhe kështu jemi gati për zbatim praktik, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj, si në realizimin e aktiviteteve brenda orës mësimore, në dhënien e detyrave të shtëpisë, në aktivitetet ekstrakurrikulare, po ashtu edhe në aktivitetet jashtëkurrikulare. Në këtë rast, na mbetet vetëm të zbatojmë metodologjitë e mësimdhënies të planifikuar.

Si mund të përzgjidhet metodologjia e mësimdhënies në funksion të kompetencave?

Rezultatet e të nxënit për shkallë - kompetencë (RNSH) dhe rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF), pos që janë pika referuese të përzgjedhjes së përmbajtjes mësimore, temave mësimore, respektivisht njësive mësimore në planifikimet e procesit mësimor, na ndihmojnë edhe në përzgjedhjen e metodologjisë së mësimdhënies dhe të të nxënit në pajtim me filozofinë dhe parimet e KKK-së. (shih me lart dokumentin në pjesën II.2 Parimet e arsimit parauniversitar si referenca të organizimit të punës edukativo-arsimore dhe pjesën e planifikimit - modelet e planifikimeve mësimore).

Shembull të ndërlidhjes së metodave dhe teknikave mësimore në funksion të rezultateve të kompetencave, respektivisht të parimeve të KKK-së në planin mësimor të punuar nga një mësimdhënëse e klasës së dytë.

Plan i orës mësimore

Lënda: Njeriu dhe natyra
Klasa: II
Tema: Bimët/ Njësia: Pjesët e bimëve dhe zhvillimi i tyre
Mjetet e punës: fleta të bardha, ngjyra, lapsa, fletore
Qëllimi: Të njihen me zhvillimin e bimës dhe llojet e saj
Rezultatet e kompetencës: I.3,II.6,VI.3,VI.6
Përdorimi i teknologjisë informative: Bim-projektor
Lidhja me lëndët e tjera: Art, Matematikë, Gjuhë shqipe
Fjalët kyçe: trungu, kërcelli, gjethet, rrënjët,
Rezultatet e të nxënit Pas hulumtimit të bimës në oborr të shkollës, nxënësi do të jetë në gjendje të: <ol style="list-style-type: none">1. Hulumtojë tiparet themelore të ndërtimit të bimës mbi bazën e kritereve të hulumtimit;2. Tregojë procesin e zhvillimit të bimës sipas rendit të caktuar;3. Dallojë bimët për nga lloji, duke u bazuar në formën e tyre.
Kriteret e suksesit Nxënësi: <ol style="list-style-type: none">1. Hulumton bimët sipas kritereve të caktuara;2. Shënon së paku 5 karakteristika të një bime;3. Gjen së paku 3 dallime dhe ngjashmëri me bimët e grupeve të tjera.

Pjesa hyrëse: 7-10 minuta

Luhet loja e lules

Nxënësit ndahen në çifte (A & B). A-të e luajnë rolin e farës, rrinë të ulur në pozitë të kërrusur. B-të me anë të lëvizjeve e ujisin dhe e bëjnë farën të ndihet mirë. A-të pasi fillojnë të ndihen mirë fillojnë të ngrihen duke simbolizuar rritjen e lules. **(kompetenca V.2)**

Nxënësit dhe mësimdhënësja ulen në rreth dhe fillon biseda ku secili nxënës tregon çka di për bimët. **(kompetenca I.3)** Mësimdhënësja i shënon këto në tabelë.

Pjesa kryesore- 25 minuta

Pastaj mësimdhënësja u tregon se do të dalin në oborr të shkollës për të hulumtuar bimët, të cilat gjenden në oborr të shkollës. Nxënësit ndahen në grupe prej 5 vetash.

Ajo u prezanton edhe kriteret për hulumtim:

- sa është gjatësia e bimës – matni gjatësinë e bimës;
- sa degë ka – numëroni degët e bimës;
- sa gjethë ka në një degë – numëroni gjethet e secilës degë;
- çfarë forme kanë gjethet – përshkruani formën e gjethes;
- çfarë ngjyre kanë gjethet – përshkruani dhe dalloni ngjyrat e gjethëve;
- trashësia e gjethëve – matni dhe përshkruani trashësinë e gjethëve;

Grupet i zgjedhin pikat/bimët dhe secili grup e hulumton bimën që e ka zgjedhë dhe i shënojnë karakteristikat kryesore që i kanë vërejtur.

Pasi kthehen në klasë secili grup e bën një vizatim të përbashkët për bimën që kanë hulumtuar dhe i shënojnë karakteristikat kryesore.

Pason prezantimi i punimeve dhe diskutohen ngjashmëritë dhe dallimet në mes të bimëve të ndryshme.

Kompetenca
II.6,
VI.3.VI.6

Rezultatet e kompetencës për temën **Bimët** janë planifikuar me kohë në planifikimin vjetor dhe më pas janë klasifikuar në planifikimin dymujor vetëm ato që mund t'i arrijmë përmes njësisë mësimore **Pjesët e bimëve dhe zhvillimi i tyre**. Po ashtu, edhe metodat dhe teknikat e mësimdhënies janë në funksion të tyre.

Rezultatet e të nxënit për shkallë (kompetenca) të përzgjedhura dhe arritshmëria e tyre përmes metodave të përzgjedhura në këtë plan mësimor janë si në vijim:

I.1 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup, në kohëzgjatje 3-5 minuta.

Në këtë rast synojmë të arrijmë kompetencën Komunikues efektiv – dhe gjithashtu jem në funksion të parimit të gjithëpërfshirjes sepse secilit nxënësi i jepet shansi të tregojë diçka për bimët

II. 6 Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta ndërmjet gjallesave, ndërmjet..., shkruan për to të paktën në një gjysmë faqeje të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërin nga format shprehëse .

Në këtë rast synojmë të arrijmë kompetencën Mendimtar kreativ, sepse nxënësi hulumton, identifikon, krahason dhe prezanton gjetjet... dhe gjithashtu jemi në funksion të parimit të mësimdhënies së integruar dhe të nxënies koherente, sepse po bëjmë mësimdhënie të ndërlidhur me natyrën dhe po mësojmë gjëra nga më të thjeshta për bimët, duke lënë vend më pas në klasat e tjera për analiza më të hollësishme për to.

V. 2 Merr pjesë në aktivitete fizike...

Në këtë rast synojmë kompetencën Individ i shëndosh sepse nxënësit duke demonstruar pozitën e bimës dhe punën që duhet bërë për përkujdesjen për to, bëjnë lëvizje fizike dhe kështu ndihmohet shëndeti.

VI.3 Arsyeton rregullat e zbatimit në lojë... dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.

VI. 6 Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar..., vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët që çojnë drejt përfundimi të një aktiviteti të caktuar.

Në këtë rast jem në funksion të kompetencës qytetar i përgjegjshëm, sepse organizimi i punës në grup dhe funksionimi i mirëfilltë kërkon domosdo respektim të rregullave.

(Rezultatet e planifikuara në planin e orës mësimore janë pjesë përbërëse e planifikimeve vjetore dhe dymujore të hartuara më parë).

Ekzistojnë shembuj e shembuj të planifikimeve në të cilët mund të identifikojmë metoda e teknika që janë në funksion të arritjes së RNSH (kompetenca) dhe të RNF, respektivisht të qëllimeve dhe parimeve të KB.

Në shembullin më lart, por edhe në shembujt e mundshëm të praktikës së mësimdhënies filozofia e KKK, KB kërkon qasje të ndryshme të mësimdhënies dhe kjo do të thotë:

- Aplikimin e metodave e teknikave të ndryshme, të cilat u mundësojnë të gjithë nxënësve kycje në procesin e të nxënit, sepse disa mund të nxënë duke vizatuar, disa duke lexuar,

disa duke dëgjuar, disa duke shikuar, disa duke lëvizur, disa me gjëra konkrete, e disa në mënyrë abstrakte..., detyrën e njëjtë. Në këtë rast, ne i kemi respektuar stilet e të nxënësve;

- Aplikimin e mësimdhënies së diferencuar, që do të thotë që detyra e njëjtë mund të ketë vështirësi të ndryshme të zgjidhjes nga nxënësit e ndryshëm. Andaj, secilit nxënës duhet ofruar rrugë, teknika të përshtatshme për zgjidhje të detyrës;
- Aplikimin e mësimdhënies që u mundëson nxënësve të nxënë duke vepruar, si në rastin e mësimin të bimës, sepse ata nxënë duke bërë vetë hulumtime. Apo shembulli nga fusha e kurrikulës Shoqëria dhe mjedisi, kur nxënësit mësojnë për rregullat, ata-ato duhet të kalojnë vetë në procesin e hartimit të rregullave, në mënyrë që të kuptojnë se çka janë rregullat., e shumë shembuj të tjerë të kësaj natyre;
- Aplikimin e mësimdhënies që mundëson të nxënësve duke ndërvepruar, nxënësit veprojnë në ndonjë objekt, ngjarje a dukuri dhe efektet e tyre ndikojnë te nxënësit, sepse përvoja që ata kalojnë gjatë këtyre proceseve u ndihmon të bëjnë apo të mos bëjnë gjëra të njëjta. Kujto “ Njeriu mëson edhe nga gabimet”;
- Aplikimin e mësimdhënies që mundëson të nxënësve duke bashkëpunuar, kujto punën në grupe, ekipe, çifte (punën me të tjerët);
- Aplikimin e mësimdhënies duke hulumtuar, sepse nxënësit vetë i gjejnë burimet e informacionit, vetë hulumtojnë (i ndajnë detyrat, i caktojnë metodat, instrumentet, kriteret, hipotezat dhe vetë përgatisin prezantimin e gjetjeve). Shih shembullin në planin mësimor për Bimët. Në funksion të nxënies duke hulumtuar është edhe puna me projekte, sepse fëmijët mësojnë si të hulumtojnë duke ndjekur procedurat e hulumtimit.

Të nxënësve duke ndërvepruar, bashkëpunuar, hulumtuar, duke u ndërlidh me jetën..., arrihet nëse kemi ofruar mësimdhënie të integruar, qoftë në rrafshin e fushave kurrikulare, por edhe në rrafshin jetësor. Nëse temat mësimore përzgjidhen nga situatat jetësore dhe trajtohen nga kënde dhe fusha të ndryshme kurrikulare, nga aspekti gjuhësor, matematikor, natyror, shoqëror, teknologjik e shëndetësor, shih shembullin e planifikimit javor. Dhe, pikë referimi i mësimdhënies janë nxënësit, sepse në përzgjedhjen e metodave dhe të teknikave marrim në konsideratë potencialet, afinitetet, interesat dhe stilet e të nxënësve të nxënësve.

Aktivitet: *Pasi që keni lexuar dhe analizuar pjesën për metodologjinë e mësimdhënies në funksion të KKK-së dhe KB-ve, reflektoni për përvojën e praktikave në klasë, për përvojën tuaj të fituar nga programet e trajnimit në metodologji të mësimdhënies dhe përgatitni/ zbërtheni qasjen metodologjike të mësimdhënies dhe nxënies për një orë mësimore, ku fokusi është metodologjia e mësimdhënies në funksion të arritjes së rezultateve të kompetencave dhe rezultateve në një fushë të kurrikulës, p.sh. **Shoqëria dhe mjedisi**.*

IV.2 Materialet mësimore (përzgjedhja dhe përgatitja e tyre)

Planifikimet mësimore me qasje të re u mundësojnë mësimdhënësve të jenë autonomë në përzgjedhjen e përmbajtjes, metodologjisë së mësimdhënies dhe gjithashtu të materialeve mësimore.

Si ndihmojnë materialet mësimore në zhvillimin e kompetencave?

Mësimdhënësit mbi bazën e përmbajtjes mësimore, metodave dhe teknikave të mësimdhënies, përzgjedhin materialet mësimore që janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të identifikuar dhe parimeve të KKK-së. Përzgjedhja adekuatë e materialeve konform temës mësimore dhe potencialeve të nxënësve ndikon në stimulimin e progresit të tyre drejt zhvillimit të shprehive dhe shkathtësive të nevojshme për jetë dhe punë.

Sot, teksti mësimor nuk konsiderohet si burim i vetëm dhe i mjaftueshëm për zhvillimin e kompetencave të nxënësit, sepse nuk mund t'i përcjellë zhvillimet e shpejta që po ndodhin në fushat e ndryshme të jetës shoqërore dhe gjithashtu nuk është i përshtatshëm për gjithë nxënësit/et të së njëjtës moshë sa u përket niveleve të njohjes.

Kjo na bën me dije se mësimdhënësit duhet të sigurojnë edhe materiale të tjera mësimore për të ndihmuar nxënësit në zhvillimin e kompetencave. Materialet mësimore nuk do të thotë të jenë domosdo të shtrenjta dhe të sofistikuar. Shumë aktivitete mësimore mund të realizohen edhe me materiale të krijuara nga mësimdhënësit, por edhe nga vetë nxënësit, kujto të nxënit duke vepruar! Krijimi i këtyre materialeve mund të bëhet edhe me materiale ricikluese, si letër, gazeta, rroba të vjetra, ambalazhe të ushqimeve, copëza të drurit, gjethe, litarë, kapëse rrobash..., miell, krip, sheqer, ujë etj., respektivisht me gjëra të cilat mund t'i ketë çdo shtëpi dhe që nuk i përdor më. Gjithashtu, në disa raste mësimdhënësit së bashku me nxënës mund t'i riciklojnë edhe vetë.

Shembull: kuptimi i ndërvarësisë ekonomike mund të zhvillohet me ambalazhet e produkteve ushqimore, duke i lexuar vendet e prodhimeve dhe duke i identifikuar vendet në hartë të siguruar nga mësimdhënësi (apo të punuar nga vetë nxënësit të kësaj moshe apo të klasave të larta). Përmes ambalazheve nxënësit mund mësojnë edhe për përbërjen e produkteve, për mënyrën e përdorimit... etj.

Shembull: Rroba të vjetra për të krijuar veshje për dramatizime të ndryshme dhe mjete didaktike, të cilat mësimdhënësit, respektivisht nxënësit, i përdorin në përditshmërinë e mësimdhënies dhe të nxënies.



Shembull: Letër, për të krijuar fletëza mësimore ku i mundësohet secilit nxënës qasje individuale, pastaj domino – që mundëson të nxënit në grup, shkronja..., materiale të tjera.

Shembull: Gazeta, për të krijuar poster, materiale matematikore, por edhe të fushave të tjera kurrikulare. Shih në foto formimit të kubit me gazeta.

Shembull: Ujë, sheqer, për të mësuar tretjen etj.

Pra, ekzistojnë mundësi të ndryshme të krijimit të materialeve mësimore, duke shfrytëzuar për lëndë të parë materiale ricikluese që do të lehtësonin procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Për të bërë këtë është mirë që në shkollë të sigurohet një vend ku grumbullohen materiale të tilla që mësimdhënësit dhe nxënësit t'i kenë çdoherë në dispozicion.



Për realizimin e aktiviteteve të planifikuara mësimdhënësi mund të përdorë burime të ndryshme, qoftë elektronike, por edhe të shkruara, si: librat të punës, broshura, atllase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza statistikore, dëshmitarë, përfaqësues të shoqërisë civile, prindër etj.

IV.3 Aspektet metodologjike dhe praktike të vlerësimit

Pas gjithë përgatitjeve për një fillim të mbarë të procesit mësimor (kujto llojet e planifikimeve dhe metodologjitë e mësimdhënies), interes i mësimdhënësit është përcjellja dhe vlerësimi i vazhdueshëm i secilit

Vlerësimi është proces i mbledhjes së informatave dhe i nxjerrjes së gjykimeve lidhur me arritshmërinë ose performancën e nxënësve. Shih fjalorthin në KKK.

nxënës në kontekstin e arritjes së rezultateve të planifikuara për periudha të caktuara kohore. Duke u bazuar në dy llojet e rezultateve të të nxënit në nivel shkalle kurrikulare (kujto RNSH-kompetenca dhe RNF) dhe në planifikimet vjetore, dymujore dhe më pas javore të orës mësimore, edhe përcjellja dhe vlerësimi i performancës së nxënësve në raport me këto planifikime duhet të jetë në përputhshmëri me llojet e vlerësimit, siç janë përcaktuar në KKK, respektivisht KB për klasën parafillore dhe arsimin fillor (shih KB, f. 108-112). Kjo do të thotë se gjatë tërë vitit shkollor (mësimor) do të bëhet vlerësimi e vazhdueshëm i performancës së secilit nxënës dhe fokus duhet të jenë arritjet e rezultateve të që janë planifikuar në planifikimet dymujore, javore e të orës mësimore. Mbi mesataren e vlerësimit të vazhdueshëm, respektivisht mbi mesataren aritmetike të notave numerike që nxënësi është vlerësuar nga mësimdhënësi gjatë tërë vitit shkollor bëhet vlerësimi përfundimtar në nivel klase dhe për secilën fushë kurrikulare apo lëndë mësimore, nxënësit i vendoset nota shkronjë siç është paraparë në KB. Me të njëjtën procedurë duhet vazhduar me vlerësimin edhe në klasat pasuese përbrenda shkallës së caktuar kurrikulare dhe kështu për të arritur te vlerësimi përmbyllës në nivel shkalle kurrikulare (lexo procedurat e vlerësimit përfundimtar dhe përmbyllës në KB.)

Vërejtje! Për derisa të merret një vendim nga MASHT-i për klasat e shkallë së parë kurrikulare se si do të bëhet vlerësimi, vlerësim numerik apo përshkrues, ju në klasën parafillore mund të bëni vlerësimin përshkrues, për të filluar më pas nga klasa e parë me vlerësimin numerik.

Për të konstatuar nivelin e arritjes së rezultateve të planifikuara në planifikime duhet kërkuar çdoherë prova dhe dëshmi në performancat e secilit nxënës-e.



Çfarë duhet bërë që vlerësimi të jetë efektiv?

Duke u nisur nga të kuptuarit praktik të konceptit të vlerësimit, mësimdhënësi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve së pari duhet të caktojë qëllimin i vlerësimit, apo duhet bërë vetes pyetjen pse po dëshiroj të vlerësoj? P.sh. po vlerësoj për të planifikuar, po vlerësoj për të konstatuar nivelin e progresit të arritjeve të kompetencave, apo rezultateve të fushave kurrikulare, lëndës mësimore, njohuritë akademike të nxënësve, po vlerësoj për të përmirësuar mësimdhënien, vlerësoj përvojat e nxënësve, mënyrën e të nxënit (stilet) etj. Vlerësimi çdoherë duhet jetë i planifikuar me kohë, e ndoshta edhe të bëhet edhe pjesë përbërëse e planifikimeve mësimore (shih planifikimin dymujor dhe të orës mësimore – kriteret e suksesit).

Cilat procedura mund të ndjekim që të matim progresin në arritjen e rezultateve të kompetencave?

Nëse dëshirojmë të matim progresin në arritjen e kompetencave, preferohet të ndjekim këtë procedurë:

- Së pari për fushën e caktuar kurrikulare përcaktojmë se cilat rezultate të kompetencave të planifikuara në planifikime mësimore do t'i matim;
- Pastaj përcaktojmë nivelin e arritjes të kompetencës për moshën e nxënësve, sepse këto rezultate, siç e dimë, duhet të arrihen deri në fund të shkallës, prandaj edhe duhet zbrërthyer për klasë (Kujto zbrërthimin e rezultateve të kompetencave për klasë! Shih pjesën e udhëzuesit kur flitet për rezultatet e të nxënit për shkallë –kompetencë /RNSH dhe arritshmëria e tyre, shembullin e zbrërthimit të rezultatit I. 1);
- Më pas caktohet tema a njësia mësimore, përmes së cilës e matim rezultatit e kompetencës;

- Dhe, në fund caktohet teknika dhe instrumenti adekuat, përmes të cilës matet rezultati i kompetencës (RNSH). Kujdes, rezultatet e kompetencave nuk janë vetëm njohuri, por edhe shkathtësi, qëndrime, vlera dhe rutina. Shih KB, fushat kurrikulare, pjesën e vlerësimit.

P.sh., te klasa III nxënësit mësojnë vizatimin e lirë dhe përmes imazheve të paraqitura ata zhvillojnë njohuritë, qëndrimet, shkathtësitë, duke realizuar paraqitjen e një objekti të caktuar;
Qëndrimet, vlerat dhe besimet: I përgjegjshëm, bashkëpunues, respekton rregullat, i sigurt;
Njohuritë: Shkëmben përvojat, identifikimi, përshkrimi, skicimi;
Shkathtësitë: Diskuton në grup, pjesëmarrje aktive, zbaton parimet.

Si mund të bëhet vlerësimi i arritjeve të rezultateve të të nxënit përmes njësisë mësimore?

Pasi keni përzgjedhur njësinë mësimore që do të zhvilloni në ditët në vijim, hartoni një plan vlerësimi për këtë njësi. Përcaktoni rezultatet e të nxënit mbi bazën e RNSH dhe RNF (RNL), zgjidhni një teknikë të vlerësimit dhe caktoni kriteret e suksesit (kujtoni planifikimin e orës mësimore).

Shembull i një modeli të një plani të vlerësimit të rezultateve të të nxënit për një njësi mësimore:

Fusha e kurrikulës /Lënda: Njeriu dhe natyra

Njësia mësimore: Pjesët e bimëve dhe zhvillimi tyre

Detyra kryesore me nxënës: Në grupe, kryejnë hulumtimin për pjesët e bimëve dhe zhvillimin tyre.

Instrument: tabela vlerësuese e mësimdhënësit (mund të jetë listë kontrolli, shih shtojcën) / dëshmia: Vizatimi i përbashkët i grupit për bimën që kanë hulumtuar dhe shënime të karakteristikave kryesore të tyre.

Rezultatet e të nxënit: Nxënësi:

1. Hulumton tiparet themelore të ndërtimit të bimës mbi bazën e kriterëve të hulumtimit;
2. Tregon procesin e zhvillimit të bimës sipas rendit të caktuar;
3. Dallon bimët për nga lloji duke u bazuar në formën e tyre.

Kriteret e suksesit: Nxënësi

1. Hulumton bimët sipas kriterëve të caktuara;
2. Shënon së paku 5 karakteristika të një bime;
3. Gjen së paku 3 dallime dhe ngjashmëri me bimët e grupeve të tjera;
4. Merr pjesë në ndarjen dhe realizimin e detyrave në grup.

Tabela vlerësuese nga mësimdhënësi			
Kriteret e zbërthyer	Ka nevojë për përmirësim	I realizuar	Nivel i lartë
Kriteret e hulumtimit të bimës	Nxënësi nuk hulumton sipas kërkesave të caktuara	Nxënësi hulumton sipas kërkesave të caktuara, por më vështirësi	Nxënësi hulumton sipas kërkesave të caktuara dhe përsërit hulumtimin me sukses
Karakteristikat e një bime	Nuk shënon asnjë karakteristikë të bimës	Shënon më pak se 5 karakteristika të bimës	Shënon 5 karakteristika të bimës
Dallimet dhe ngjashmëritë mes bimëve	Nuk gjen asnjë dallim dhe ngjashmëri mes grupeve të bimëve	Gjen më pak se 3 dallime dhe ngjashmëri mes grupeve të bimëve	Gjen 3 e më shumë dallime dhe ngjashmëri mes grupeve të bimëve
Puna ne grup dhe ndarja e detyrave	Ka orvatje individuale për ndarjen e detyrave	Ka orvatje të përbashkëta por rolet nuk janë gjithnjë të qarta	Bashkërisht ndajnë detyrat dhe kryejnë ato

Shih më poshtë strategjinë, përkatësisht instrumentin, rubrikën dhe në shtojcë listat e kontrollit

Cilat janë dimensionet e performancës së nxënësve për raportim?

Zhvilluesit e përshkruesve të niveleve të performancës janë të dobishëm, sepse ata përqendrohen në përshkrimin të asaj se si nxënësit i kanë arritur standardet sipas dimensioneve: komunikimit, zgjidhjes së problemeve, shfrytëzimit të TIK-ut (*shtrirja, shpeshësia, ndihma/fascilitimi, thellësia, kreativiteti dhe cilësia* e njohurive, aftësive dhe shkathtësive që ata i kanë fituar). Ky lloj formati ndihmon përcjelljen progresive të RNSH (kompetencave). Shih përmbajtjen e secilit dimension.

Komunikimi: i referohet komunikimit të dijes dhe aftësive të fituara brenda fushës së kurrikulës të tjerët, përfshirë këtu nxënësit dhe mësimdhënësit.

Zgjidhja e problemeve: i referohet zgjidhjes së problemeve rutinore dhe të reja, të thjeshta dhe komplekse, brenda fushës së kurrikulës.

Përdorimi i TIK-ut: i referohet përdorimit të kompjuterëve dhe teknologjisë tjetër informative brenda fushës së kurrikulës.

Shtrirja: i referohet shtrirjes së të kuptuarit të rezultateve të të nxënësve të kurrikulës që janë zotëruar dhe cili është niveli i arritjes së rezultateve të të nxënësve për shkallë/fushë.

Shpeshësia: i referohet sa shpesh nxënësi demonstroi mjeshtëri gjatë procesit mësimor dhe sa shpesh nxënësi është në gjendje të demonstrojë zotërimin e një kompetence.

Ndihma/facilitimi: i referohet nivelit të njohurive, aftësie, shkathtësive dhe qëndrimeve, apo dhuntive që posedon dhe tregon një nxënës. Nxënësi është i qartë për atë që e thotë apo e demonstroi, duke arsyetuar, andaj klasifikohet si një person që të tjerët mund të mësojnë nga ai, apo ai u ndihmon të tjerëve.

Thellësia: i referohet thellësisë që nxënësi ka përmbushë rezultatet e të nxënësve përmes niveleve të dijes.

Kreativiteti: i referohet aftësisë së nxënësit për të shkuar përtej asaj që është mësuar. Në termin “produkt” është aftësia për të krijuar diçka të re, përmes frymëzimit, imagjinatës, vizionit, inspirimit dhe zgjidhjes së problemit në situata të reja.

Cilësia: i referohet njohurive dhe aftësive për të parë të mësuarit e nxënësve dhe përfshin identifikimin dhe tiparet kryesore të të mësuarit të nxënësve dhe se mësimi klasifikohet sipas shkallëve të përsosshmërisë dhe vlerave.

Tabela e mëposhtme tregon disa nga termat që mund të përdoren në një sistem të performancës në nivel të klasifikuar të mësuarit të nxënësve në përputhje me secilin nga dimensionet.

DIMENSIONI	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5
Komunikimi	<i>pasiv</i>	<i>me vështirësi</i>	<i>Sipërfaqësisht</i>	<i>me lehtësi</i>	<i>rrjedhshëm</i>
Zgjidhja e problemeve	<i>asnjë element</i>	<i>të thjeshta</i>	<i>të zakonshme</i>	<i>mesatar</i>	<i>kompleks</i>
Shfrytëzimi i TIK-ut	<i>asnjë element</i>	<i>i varfër</i>	<i>i mirë</i>	<i>shumë mirë</i>	<i>i avancuar</i>
Shtrirja	<i>aspak</i>	<i>ngushtë</i>	<i>pjesërisht</i>	<i>plotësisht</i>	<i>zgjeruar</i>
Shpeshtësia	<i>asnjëherë</i>	<i>rrallë</i>	<i>nganjëherë</i>	<i>zakonisht</i>	<i>përherë</i>
Facilitimi	<i>asnjë element</i>	<i>ngadalë</i>	<i>në mëdyshje</i>	<i>shpejtë</i>	<i>automatikisht</i>
Thellësia	<i>asnjë element</i>	<i>sipërfaqësisht</i>	<i>cekët</i>	<i>adekuate</i>	<i>thellësisht</i>
Kreativiteti	<i>pasiv</i>	<i>imitues</i>	<i>i zakonshëm</i>	<i>imagjinues</i>	<i>krijues</i>
Cilësia	<i>dobët</i>	<i>varfër</i>	<i>mangët</i>	<i>sh. mirë</i>	<i>shkëlqyeshëm</i>

Disa aspekte praktike të strategjive, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit

Me rastin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve mund përdorim strategji, teknika dhe instrumente të ndryshme, varësisht se çfarë dëshirojmë të matim. Shih disa shembujt në vazhdim.

Për të vlerësuar bashkëpunimin dhe realizueshmërinë e kryerjes së detyrës, si dhe punën në grupe, mund të përdorim **Buletini i pjesëmarrjes**, si teknikë dhe dëshmi për vlerësim.



Për të vlerësuar nxënësin në formë të vazhdueshme, ku matim, njohuritë, qëndrimet, vlerat..., mund të përdorim **Listën e kontrollit (shih shtojcën)**, e cila shërben si instrument për të regjistruar përparimin e nxënësve në vazhdimësi.

Nxënësit e klasës parafillore dhe të arsimit fillor angazhohen dhe në aktivitete kreative, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e psiko-motorikes, njëri ndër ta është edhe krijimi i librave p.sh. Në fushën e kurrikulës Jeta dhe puna. Këto nxisin kreativitet në krijimin e modeleve të ndryshme. Procesi i punës së krijimit të tyre, por edhe vetë produkti si dëshmi mund të jenë fokus i vlerësimit.



Pastaj angazhimi në krijimin e filmave ku nxënësit shprehin talentin e tyre në shkrimin e skenarit, bashkimin e videove. Përmes këtij aktiviteti nxënësit zhvillojnë shkathtësi teknike dhe aftësi për planifikime të veprimeve praktike, duke u bërë kontribuues dhe bashkëpunues për mjedisin. Atëherë ne i matim shkathtësitë në fjalë.

Broshura është një strategji dhe dëshmi, e cila ndihmon të matim rezultatet e të nxënit. Gjatë krijimit të broshurës nxënësi fiton njohuri, shkathtësi dhe qëndrime që ndihmojnë në përmbushjen e kompetencave, me çka mund të matet vlerësimi sasior dhe cilësor.

Njëra ndër strategjitë dhe instrument për vlerësim është edhe **Rubrika** e krijuar nga nxënësit që do të shërbejë për vetëmatjen e nivelit të njohurive të tyre. Kjo strategji e vlerësimit bazohet kryesisht në rezultatet e të nxënit të



orës mësimore (shih planet e orës mësimore). Aktivitetet duhet të përshtaten këtyre rezultateve. Gjithashtu, është mirë që mësimmhënësi për punën e vet në raport me vlerësimin të përcaktojë nivelet e arritshmërisë mbi bazën e ngjyrave të përcaktuara në rubrika. Shembull ngjyra e gjelbër tregon nivelin e arritjes së lartë, ndërsa ngjyra e verdhe nivelin e arritjes së pjesshme dhe ngjyra e kuqe nivelin e arritjes së ulët.

	E gjelbër	E verdhë	E kuqe
Shkruani përmbajtjen e tekstit	Kam shkruar gjithë përmbajtjen e tekstit	Kam shkruar vetëm një pjesë të tekstit	Kam shkruar shumë pak për përmbajtjen e tekstit
Vizato një skemë që mund t'i përshtatet teksti	Kam vizatuar skemën që i përshtatet shumë tekstit	Kam vizatuar një skemë që përshtatet deri diku me tekstin	Kam paraqitur vetëm një vizatim të thjeshtë
Emërto personazhet në tekst	I emërtova të gjithë personazhet në tekst	Emërtoj personazhet e tekstit por më ngatërrohen	Përveç njërit, të tjerat personazhe s'mund t'i emëroj

Përcjellja e zhvillimit të kompetencave arrihet kur kemi më shumë të dhëna të akumuluar për të nxënëit e fëmijëve dhe instrumenti më i përshtatshëm për mbledhjen e të dhënave për vlerësim është edhe dosja.

Dosja (portfolio)

Është një koleksion i qëllimshëm i punimeve të nxënësve që tregon për përpjekjet, përparimin dhe të arriturat e tij në fushë kurrikulare të caktuar. Këtu përfshihet pjesëmarrja e nxënësit në përzgjedhjen e përmbajtjes së dosjes, udhëzimet për përzgjedhje dhe kriteret e vlerësimit për të dëshmuar për meritat dhe dëshmitë e vetë-reflektimit të nxënësit. (Arter&Spandel,1992) (32).




Ky lloj i vlerësimit është vlerësim për të nxënë, pasi që për një kohë të gjatë vazhdimisht mblidhen informata për zhvillimin e nxënësit.

Është me rëndësi që të vendosni për qëllimet e dosjes, të caktoni rezultatet e pritura dhe si mund të shfrytëzohet dosja për t'i përmbushur ato rezultate.

Ky lloj i vlerësimit/strategjisë ndihmon në arritjen e njohurive, zhvillimit të shkathtësive dhe qëndrimeve. Ndërsa, stili i të nxënëit te kjo strategji është: pamor, lëvizor.

Krijimi i dosjes



Mbani mend: Nxënësit me dhunti kanë nevojë për mbështetjen tuaj dhe ne ju urojmë shumë fat derisa e filloni sfidën e të bërit ndryshime për fëmijët e talentuar në klasën tuaj! Në fund të fundit, një person mundet dhe bën ndryshime.

Përshtatur nga Instituti Davidson për Zhvillim të Talenteve

IV.4 Bashkëpunimi i mësimeve, si domosdoshmëri për zbatim të kurrikulës së re

Çelësi i suksesit të nxënësve qëndron në bashkëpunimin kolegjial të mësimeve. Kjo do të thotë që në mes të mësimeve nuk duhet të ketë xhelozë, sepse të gjithë synojnë zhvillimin maksimal të potencialeve të nxënësve; nuk duhet të kenë frikë dhe turp nga njëri-tjetri, sepse të gjithë janë përgatitur për përkrahje të nxënësve; nuk duhet t'u vijë turp të kërkojnë ndihmë, sepse këtë e bëjnë për nxënës. Mos harro! **Transparenca eliminon çdo vështirësi!**

Si mund të bëhet bashkëpunimi?

Zbatimi i filozofisë së KKK-së domosdoshmërisht kërkon bashkëpunimin ndërmjet mësimeve. Bashkëpunimi duhet të bëhet në **nivel të këshillit të klasës-klasave**, por edhe të **aktiveve profesionale**.

Mësimeve të klasës së njëjtë, por të paraleleve të ndryshme, duhet të bashkëpunojnë ndërmjet vete, por edhe me mësimeve të arsimit të mesëm të ulët të fushave kurrikulare. Ky bashkëpunim duhet të reflektohet në planifikime mësimore, që do të thotë se mësimeve të klasës së njëjtë, por të paraleleve të ndryshme, duhet bashkërisht të hartojnë planifikimet për shkallë dhe planifikimet vjetore, për të vazhduar më pas në shkëmbimin e ideve dhe përvojave në hartimin e planifikimeve dymujore, të cilat mund të jenë edhe të ndryshme nga mësimeve të paraleleve të ndryshme. Gjithashtu, mësimeve të duhet të ndihmojnë njëri-a tjetrin-ën në planifikimet javore, edhe pse ata-ato janë përgjegjëse vetëm për një paralele.



Bashkëpunimi i mësimeve duhet të reflektohet edhe në shkëmbimin e përvojave të metodologjisë së mësimdhënies, të vlerësimit, në krijimin dhe shkëmbimin e materialeve mësimore etj.

Mësimeve mund të marrin iniciativë për ngritje profesionale brenda shkollës, duke mbajtur vetë punëtori për çështje të ndryshme që janë në funksion të mësimdhënies.

Mësimeve bashkërisht mund t'i përgatisin nxënësit edhe për gara të ndryshme, për kuize diturie, gara sportive, ekspozita dhe aktivitete të tjera që ndihmojnë në zhvillimin e kreativitetit dhe në arritjen e kompetencave të caktuara.

Gjithashtu, suksesin e zbatimit të KKK-së e forcon edhe bashkëpunimi me mësimeve të shkollave të tjera, duke shkëmbyer përvoja, literaturë, linçe, informata e njohuri të marra nga trajnimet e ndryshme.



SHTOJCË

Modele të planifikimeve të mësimdhënësve të shkollave pilot dhe materiale të mësimdhënies dhe të vlerësimit të përdorura nga ata.

Ato mund të jenë të ndryshme nga shkolla në shkollë.

Shtojca 1 : Disa folje vepruese për hartimin e rezultateve të të nxënit dhe kritereve të vlerësimit

Gjetja e fjalëve të duhura për hartimin e rezultateve të të nxënit/kritereve të vlerësimit mund të jetë e vështirë, veçanërisht kur fjalitë duhet të përputhen me nivelin e përgjithshëm të përshkrimit. Lista në vijim mund të përdoret për të ju ndihmuar në këtë proces. Fjalët janë të organizuara në nëntituj që korrespondojnë me astronominë e Bloom-it. Megjithatë, kjo renditje nuk paraqet kurrfarë hierarkie. Fjalët përbëjnë thjeshtë një listë të vokabularit të vjelur nga burime të ndryshme për të ju ndihmuar në hartimin e rezultateve të të nxënit dhe kritereve të vlerësimit.

Foljet që kërkojnë fakte për njohuritë: Defino, përshkruaj, identifikoj, emëro, listo, riprodho, përsërit, përzgjedh, deklaro, prezanto, ji i vetëdijshëm, nxjerr, organizo, rinumëro, shkruaj, prano, mat, nënvizo, ndërlidh, bashko.

Foljet që kërkojnë fakte për të kuptuarit: Interpret, përkthe, llogarit, arsyeto, shpreh, konvert, qartëso, mbro, dallo, shpjego, zgjero, gjeneralizo, ilustr, ofro shembuj, parafrazo, parashiko, rishkruaj, përmbledh, diskut, përform, report, prezanto, identifikoj, trego, gjej, përzgjedh, kupto, përfaqëso, emëro, formul, gjyko, krahaso, klasifikoj, shpreh.

Foljet që kërkojnë fakte për të njohuri/kuptuarit: Apliko, zgjidh, ndërto, demonstr, ndrysho, llogarit, zbulo, manipul, modifik, oper, parashiko, përgatit, prodho, ndërlidh, trego, përdor, jep shembuj, hart, përzgjedh, shpjego, gjej, vlerëso, ushtr, ilustr, verifik.

Foljet që kërkojnë fakte për analizë: Prano, dallo, vlerëso, analiz, zërbër, diferenc, identifikoj, ilustr, përshkruaj, përmend, ndërlidh, përzgjedh, ndaj, nëndaj, krahaso, justifik, zgjidh, egzamin, përmbledh, kritik, kontest, diagnostifik, identifikoj, kategoriz, shpjego.

Foljet që kërkojnë fakte për sintezë: Propoz, prezanto, ndërto, integro, formul, mëso, zhvillo, kombin, kompoz, krijo, ndajë, dizajn, shpjego, gjener, modifik, organiz, planifik, riaranzho, rinderto, ndërlidh, riorganiz, rishiko, shkruaj, përmbledh, trego, raport, ndrysho, argument, rendit, përzgjedh, menaxho, gjeneralizo, nxjerr, përfund, shkakt, sintetiz, sugjero, zgjero.

Foljet që kërkojnë evidencë për vlerësim: Gjyko, vlerëso, përmbledh, krahaso, përshkruaj si, kritik, shpërndaj, arsyeto, mbro, grado, përcakto, zgjedh, çmo, kontest.

Gosling, D. & Moon, J. (2002) How to use Learning Outcomes 6 Assessment Criteria - Learning Development Unit, London Metropolitan University. UK.

Krahasimi i rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e fushës së kurrikulës bërthamë (KB),

Rezultatet e të nxënës të fushës (RNF) Gjuhët dhe komunikimi marr nga KB	Rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese të lëndëve mësimore që korrespondojnë në RNF		Rezultatet e pritshme që duhet të shtohen në planet dhe programet e lëndëve mësimore				Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL)						
	Klasat		Klasat				Klasat						
	E tretë	E katërt	E pestë	E tretë	E katërt	E pestë	E tretë	E katërt	E pestë				
Nxënës/ja:	Nxënës/ja:	Nxënës/ja:	Nxënës/ja:	Nxënës/ja:	Nxënës/ja:	Nxënës/ja:	Nxënës/ja:	Nxënës/ja:	Nxënës/ja:	Nxënës/ja:	Nxënës/ja:	Nxënës/ja:	Nxënës/ja:
HAPI PARË	HAPI DYTË	HAPI TRETË	HAPI KATËRT	HAPI PESTË	HAPI DYTË	HAPI TRETË	HAPI KATËRT	HAPI PESTË	HAPI DYTË	HAPI TRETË	HAPI KATËRT	HAPI PESTË	HAPI DYTË
Gjuhë amtare -shqipe	Gjuhë amtare -shqipe	Gjuhë amtare -shqipe	Gjuhë amtare -shqipe	Gjuhë amtare -shqipe	Gjuhë amtare -shqipe	Gjuhë amtare -shqipe	Gjuhë amtare -shqipe	Gjuhë amtare -shqipe	Gjuhë amtare -shqipe	Gjuhë amtare -shqipe	Gjuhë amtare -shqipe	Gjuhë amtare -shqipe	Gjuhë amtare -shqipe
Gjuhë angleze	Gjuhë angleze	Gjuhë angleze	Gjuhë angleze	Gjuhë angleze	Gjuhë angleze	Gjuhë angleze	Gjuhë angleze	Gjuhë angleze	Gjuhë angleze	Gjuhë angleze	Gjuhë angleze	Gjuhë angleze	Gjuhë angleze

shkalla 2

Fusha Gjuhët dhe komunikimi

Udhëzime për plotësimin e tabelës:

Krahasimi i rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e fushës së kurrikulës bërthamë (KB).

Për plotësimin e kësaj tabele duhet t'i ndiqni disa hapa .Të njëjtat sugjerime vlejné për çdo lëndë dhe për çdo klasë.

Hapi i parë

Në kolonën e parë të tabelës, me emërtim **Rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Gjuhët dhe komunikimi, marrë nga KB**, duhet të vendosen rezultatet origjinale (ashtu siç janë) të të nxënit të fushës kurrikulare, të cilat mund t'i merrni në dokumentin e Kurrikulës bërthamë për shkallën e caktuar. Këto rezultate janë të vlefshme për të gjitha lëndët, të cilat i përkasin fushës së kurrikulës për shkallën dhe klasën e caktuar.

Hapi i dytë

Në kolonën (kolonat) e tabelës ku janë klasat dhe përmbi to është emërtimi **Rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese të lëndëve mësimore, që korrespondojnë me RNF**, në secilën klasë duhet të vendosni rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese. Këto rezultate të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese që i vendosni në këto kolona duhet të jenë vetëm ato që korrespondojnë me rezultatet e të nxënit të fushës (RNF), dhe duhet të jene origjinale, ashtu siç janë në plan dhe program.

Hapi i tretë

Në kolonën (kolonat) e tabelës ku janë klasat dhe përmbi to është emërtimi **Rezultatet pritshme, që duhet të shtohen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (kujto planifikimet dymujore)**, duhet të vendosen rezultatet e pritshme, që ju mendoni se duhet të shtohen, meqenëse rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese nuk i përmbushin mjaftueshëm rezultatet e të nxënit të fushës (RNF).

Hapi i katërt

Në kolonën (kolonat) e tabelës ku janë klasat dhe përmbi to është emërtimi **Rezultatet e përpunuara përfundimtare, që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL) (kujto planifikimet dymujore)**, puno sipas kësaj ecurie, merrni rezultatet e **hazit të dytë** - rezultatet e planeve dhe programeve ekzistuese të lëndës së caktuar të klasës së caktuar që korrespondojnë me rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) dhe merrni rezultatet e **hazit të tretë** - rezultatet pritshme të shtuara dhe vendosni në klasën-klasat e caktuara, përmbi së cilave është emërtimi **Rezultatet e përpunuara përfundimtare, që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL)**. Këto rezultate duhet të jenë versioni final i dy hapave, të hazit të dytë dhe të hazit të tretë. **Rezultatet e këtyre dy hapave (hazit të parë dhe hazit të dytë) duhet lexuar me kujdes dhe të përpunuara të vendosen në klasën – klasat që kanë emërtimin Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL) (kujto planifikimet dymujore).**

Shih shigjetat në tabelë më sipër.

Kjo tabelë është e vlefshme për një shkallë, do të thotë për sa klasë që ka shkalla – për një gjeneratë.

- Atëherë mësuesi duhet të vendosë për një gjeneratë (për nxënësit e njëjtë) se cilat rezultate duhet t'i arrijnë për secilën klasë, p.sh. çka për klasën parafillore, çka për klasën e parë dhe çka për klasën e dytë.
- Procedurë e njëjtë duhet të ndiqet për të gjitha shkallët, si për shkallën 1, si për shkallën 2..., apo shkallën 6.
- Përrjashtim ka klasa e parë, sepse nxënësit në klasën parë mund të mos kenë shkuar në klasën parafillore, andaj rezultatet për klasën e parë ndoshta prapë do të jenë start i të gjithë nxënësve, si për ata që kanë qenë në klasën parafillore, si për ata që nuk kanë qenë në këtë klasë. Mësuesit duhet të jenë të kujdesëm kur të shkruajnë rezultatet në kolonën me emërtim: **Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL)**, sepse në klasë të parë ka nxënës me përgatitje të ndryshme.

Ky paragraf është i vlefshëm për të gjitha shkallët dhe u dedikohet kolonave me emërtim **Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL) (kujto planifikimet dymujore).**

Shtojca 2: Modele të planifikimeve të përgatitura nga mësimdhënësit
Plani vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës Gjuhët dhe komunikimi
Viti shkollor 2013-2014, Klasa e parë

Fusha e kurrikulës	Konceptet e fushës kurrikulare (marr nga KB)	Rezultatet e fushës së kurrikulës bërthamë (KB) marrë nga KB	Temat mësimore që trajtohen gjatë një viti mësimor për secilin fushë kurrikulare	Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve					Rezultatet e kompetencave (Rezultatet e të nxënimit për shkallë)
				Shtator-tetor	Nëntor - dhjetor	Janar-shkurt	Mars-prill	Maj - qershor	
Gjuha dhe komunikimi	<p>Sistemi i gjuhës (gramatikë, leksik, fonetikë, drejtis sintaksë, drejtis hkrim)</p> <p>Tekstet letrare dhe joletrare;</p> <p>Gjuha figurative dhe jofigurative; pjesët skenike, teatri, dramati mi etj.;</p> <p>Kritika, teoria, historia;</p>	<p>I.1• Shkëmbejnë ide gjatë diskutimit, bën pyetje dhe përgjigjet duke përdorur fjalë. dhe fjali të thjeshta;</p> <p>I.2• Flet disa fjalë apo fjali, bën pyetje dhe përgjigjet duke përdorur fraza apo fjali të thjeshta, të përsëritura;</p> <p>I.3• Përdor strategji për të lexuar me kënaqësi tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë, si dhe elementet e përdorimit të gjuhës;</p> <p>I.4• Lexon me zë tregim të shkurtër dhe përdor pjesë plotësuese të tekstit (p.sh., foto, vizatim etj.). Zhvillon mekanizmat e kalimit nga leximi i thjeshtë (mekanik) në lexim-kuptim. Përflet apo parafrazon tekstet që ka lexuar.</p> <p>I.5. Përshkruan tekste sipas modeleve dhe shkruan për të komunikuar idetë e veta nëpërmjet fjalëve, fjalive ,etj..</p> <p>II.2- Identifikon të dhënat kryesore dhe konceptet nga tregimet e thjeshta.</p> <p>III.1-Përvetëson teknikat që janë për krijime përkatëse dhe i përdor në aktivitete të caktuara.</p> <p>V.1-Ndjek rregullat elementare dhe përgatit materiale për organizimin e shfaqjeve, ekspozitave në klasë .</p> <p>VI.1-Njeh disa lloje të teknologjisë dhe i përdor për aktivitete të caktuara, për të shkruar fjalë, fjali, numra, simbole, tinguj, vizatime etj.</p>	<p>Kultura e komunikimit - elementet (tingujt-shkronjat)</p>	<p>Kultura e komunikimit -format (mimika, gjestet, figurat, modelim)</p>	<p>Kultura e komunikimit - elementet (tingujt-shkronjat)</p>	<p>Kultura e komunikimit - elementet (tingujt-shkronjat)</p>	<p>Kultura e komunikimit - elementet (tingujt-shkronjat)</p>	<p>Kultura e komunikimit (të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit, të lexuarit)</p>	<p>I.1, I.3, I.4, I.5, I.6, I.7, I.8, II.3, II.4, II.7, III.1, III.2, III.3, III.5 III.6, IV.3, IV.5, IV.6, V.1, V.3, V.5, V.6, VI.2, VI.4, VI.5</p>

Plani vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës Shoqëria dhe mjedisi

Viti shkollor 2013-2014

Shkolla fillore, klasa e parë

Fusha e kurrikulës	Konceptet e fushës kurrikular e (marr nga KB)	Rezultatet e fushës së kurrikulës bërthamë (KB) marr nga KB	Temat mësimore që trajtohen gjatë një viti mësimor për secilin fushë kurrikulare	Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve					Rezultatet e kompetenca ve (Rezultatet e të nxëniet për shkallë)
				Shtator -tetor	Nëntor - dhjetor	Janar - shkurt	Mar s-prill	Maj - qershor	
Shoqëria dhe mjedisi	<p>Grupet dhe marrëdhëniet shoqërore</p> <p>Proceset shoqërore</p> <p>Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë</p> <p>Vendimmarrja</p> <p>Mjedisi</p>	<p>1. Tregon për vetveten, familjen e ngushtë dhe të gjerë (dallon moshën dhe prejardhjen), organizimin e hapësirës së banimit dhe veprimit, lëvizjet natyrore të popullsisë, migrimet, vendbanimet dhe veprimtaritë ekonomike;</p> <p>2. Identifikon dhe respekton organizime të thjeshta shoqërore;</p> <p>(familjes, klasës) dhe mënyrën se si njerëzit mund të jetojnë dhe të punojnë së bashku;</p> <p>3. Përkrauan ngjarje shoqërore, kulturore dhe historike si dhe dukuri natyrore e mjedisore duke marrë shembuj nga jeta e përditshme dhe nga e kaluara si dhe identifikon reziqet kryesore natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu, objektet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, objektet natyrore të orientimit në hapësirë dhe shkatarrët e dëmtimit të mjedisit natyror dhe human në nivel lokal, vendi dhe rajonal;</p> <p>4. Identifikon dhe respekton traditat dhe festat si pasqyrim i llojlloshmërisë kulturore, fetare, shoqërore, etnike e familjare;</p> <p>Merr vendime të thjeshta, si individ apo si anëtar i një grupi të vogël (familjes, klasës), për çështje që lidhen me situata të jetës së përditshme (p.sh., pjesëmarrja ose jo në aktivitete të caktuara grupore etj.);</p> <p>5. Identifikon llojet e thjeshta të ndodjes së mjedisit që bëhen nga faktori njeri dhe vetëdijësohet për rolin që ka në ruajtjen e tij;</p> <p>6. Përdor TIK-un dhe mediet për t'u informuar lidhur me shoqërimë dhe mjedisin.</p>	<p>Unë dhe shoqëria (familja, shkolla, komuniteti veprimtaritë ekonomike, puna dhe profesionet, festat dhe traditat, vlerat dhe qëndrimet, sjelljet)</p> <p>Detyrat, të drejtat dhe përgjegjësit e mija (rolet, vendimet)</p> <p>Mjedisi ynë (kujdesi dhe ruajtja e mjedisit)</p>	<div style="border: 1px solid red; padding: 5px; width: fit-content; margin: auto;"> Temat mësimore duhet të shpërndahen nëpër muaj, siç kërkohet në tabelë! </div>					I.1 I.3 I.4. I.5. I.6. I.7. II.1. II.3. II.4. II.5. II.6. III.1. III.3. III.4. III.6. III.7. IV.1. IV.3 IV.4 IV.5 IV.6. V.1. V.2. V.5. V.6. V.7. VI.1. VI.4 VI.5. VI.6. VI.7

Plani dymujor i njësive mësimore për tema mësimore

Fusha: Gjuhë shqipe

Klasa: E parë

Muajt: Janar-shkurt

Tema mësimore: Kultura e komunikimit – elementet (tingujt- shkronjat- Përpunim i shkronjave T, S, SH, F, RR, J, V, Q, D, DH)

Rezultatet e kompetencave që synohen të arrihen përmes temës:

I-1,3,4,6; II-5,7; III-1,2,3,4; IV-2,3; V-1,5; VI-1,2,4,6

Rezultatet e fushës kurrikulare që synohen të arrihen përmes temës:

I-1,2; II-1,2;III-1

Korrelacioni me fushat kurrikulare dhe çështjet ndërlëndore:

Matematikë, Artet, Shoqëria dhe Mjedisit, Shkencat e natyrës.

Lëndët mësimore	Rezultatet e të nxënit të lëndës	Njësitë mësimore	Koha e nevojsh me e ndarë në javë	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Burimet
Gjuhë amtare	Identifikon shkronjën T,t dhe S,s Gjen shkronjën T dhe S në struktura fjalësh me ndihmën e figurave Shkruan shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit dhe të dorës Lexon globalisht fjalët në Abetaren e Punës Shpjegon domethënien e tekstit të lexuar Gjen shkronjën S në struktura fjalësh me ndihmën e figurave Shkruan shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit dhe të dorës Lexon globalisht fjalët në Abetaren e Punës Shpjegon domethënien e tekstit të lexuar	-Analizë dhe sintezë fjalësh(Abetare pune) -Shkronja e madhe dhe e vogël T,t -Lexim dhe kuptim teksti,grupe fjalësh fjalësh -Punimi i tingullit dhe shkronjës S,s	4-orë java e parë muaji Janar	Bashkëbisedimi Ilustrimi Demonstrimi Vet-veprimi Stuhi mendimesh Punë individuale Bashkëbisedimi	Vlerësimi i vazhdueshëm Vlerësimi formativ Vlerësimi motivues	Abetarja Abetare pune Fletorja Lapsi Mjete të tjera ndihmëse CD Libra për fëmijë Abetarja Abetare pune Fletorja Lapsi Mjete të tjera ndihmëse CD Libra për fëmijë
